AGJENCIA E STATISTIKAVE TE KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2023

Prishtinë, 2024

https://ask.rks-gov.net/

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës -Agencija za Statistike Kosova -Kosovo Agency of Statistics

RAPORTI VJETOR 2023

Prishtinë, 2024

PËRMBAJTJA

Faqe

PËRMBAJTJA 3
LISTA E SHKURTESAVE 4
HYRJE 6
1. PERFORMANCA E ASK-së 9
1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë 9
1.2. Këshilli Statistikor 10
1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi 11
1.4. Llogaritë Kombëtare 14
1.5. Statistikat Ekonomike 16
1.6. Statistikat Sociale 19
1.7. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit 22
1.8. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare 24
1.9. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative 25
1.10. Racionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve në ASK 31
1.11. Pasqyrat e Performancës së ASK-së 36
2. ANALIZA E PRIORITETEVE 37
2.1. Konsolidimi i Kornizës Ligjore 37
2.2. Regjistrimi i Popullsisë 2023/24 37
2.3. Zhvillimi i kapaciteteve të tjera 37
2.4. Dialogu me përdoruesit 38
2.5. Prioritetet tjera sektoriale - Prodhimi statistikor 38
3.BUXHETI 40
4.SFIDAT 43
SHTOJCA 1. Pasqyra e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës në ASK, dhjetor 2023 44
SHTOJCA 2: Kalendari i publikimeve 2023 46

LISTA E SHKURTESAVE

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARC	-	Agjencia për Regjistrimin Civil
AEB	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore
ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtore
APR	-	Anketa Post Regjistruese
ASK-data	-	Platformë e bazuar në PX-Web
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BB	-	Banka Botërore
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
DLLK	-	Departamenti i Llogarive Kombëtare
DSE	-	Departamenti i Statistikave Ekonomike
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
DSBM	-	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DAM	-	Departamenti i Administratës dhe Mbështetjes
DMTI	-	Departamenti i Metodologjisë dhe i Teknologjisë Informative
DPPKK	-	Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IKShPK	-	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IÇIMP	-	Indeksi i Çmimeve të Importit
IHÇK	-	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IKN	-	Indeksi i Kostos së Ndërtimit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Pronës Banesore
KVP	-	Korniza e Vlerësimit të Performancës
LLKV	-	Llogaritë Kombëtare Vjetore
LLKT	-	Llogaritë Kombëtare Tremujore
MeM	-	Marrëveshje e Mirëkuptimit
MFPT	-	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
OZHQ	-	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
MASHTI	-	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PSZ	-	Programi i Statistikave Zyrtare
PVSZ	-	Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare
P5VSZ	-	Plani 5 Vjeçar i Statistikave Zyrtare
PKZMSA	-	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PP	-	Pilot Projekt
STJ	-	Statistikat e Tregtisë së Jashtme
SIPK (ang)	-	Sistemi i Përdorimit të Kohës
TM	-	Tremujor
TI	-	Teknologji Informative
TIK	-	Teknologjia Informative dhe Komunikimi
ZKM	-	Zyra e Kryeministrit
BoP (ang)	-	Bilanci i Pagesave

CoP (ang.)	-	Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane
CAPI (ang.)	-	Intervistimi Personal i Asistuar nga Pajisjet e dorës, Celularë ose Tabletë
CATI (ang.)	-	Intervistimi me Telefon i Asistuar nga Kompjuteri
CAWI (ang.)	-	Mbledhja e të dhënave përmes një shfletuesi (browser) online.
EUROSTAT(ang.)	-	Zyra Statistikore e Bashkimit Evropian
ESA 2010 (ang)	-	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare
ECP(ang.)	-	Programi i Krahasueshmërisë Evropiane
EU (ang.)	-	Bashkimi Evropian
ESMS (ang)	-	Struktura e Metadatave Euro-SDMX
ESQRS (ang)	-	Standardi ESS për Strukturën e Raporteve të Cilësisë
ESS (ang)	-	Sistemi Evropian Statistikor
ESDS (ang.)	-	Promovon dhe ofron mbështetje për të gjithë përdoruesit që janë të interesuar për të dhënat e ASK-së
e-GDDS(ang.)	-	Shpërndarja e të dhënave
eDAMIS (ang.)	-	Raportimi i të dhënave përmes Platformës së krijuar nga Eurostati
GIS (ang.)	-	Sistemi Informativ Gjeografik
GSPBM (ang.)	-	Modeli i Përgjithshëm për Përpunim të Fazave Statistikore
IPA (ang.)	-	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
ISBN (ang.)	-	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit
ISCED2011(ang.)	-	Nomenklatura për Klasifikim të Nivelit të Arsimit
IOM (ang.)	-	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
ISS (ang.)	-	Statistikat e Shoqërisë së Informacionit
MICS (ang.)	-	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
NSDP (ang.)	-	Faqe e Përmbledhjes Kombëtare
NACE (ang.)	-	Nomenklatura për Klasifikimin e Aktiviteteve Ekonomike
OECD (ang.)	-	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PRODCOM (ang)	-	Klasifikimi i Produkteve
PAPI (ang.)	-	Përdorimi i pyetësorëve në letër
Px-Axis	-	Platformë për Shpërndarjen e të Dhënave
SIDA (ang.)	-	Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SDMX (ang)	-	Shkëmbimi i të Dhënave Statistikore dhe Metadatat
SDG (ang.)	-	Treguesit e Qëllimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SILC (ang.)	-	Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës
SMIS+(ang.)	-	Sistemi i Inteligjencës së Menaxhimit të Sigurisë
UNHCR (ang.)	-	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UN (ang.)	-	Kombet e Bashkuara
UNICEF(ang.)	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNDP (ang.)	-	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA (ang.)	-	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Aktivitetet e Popullsisë

HYRJE

Viti 2023, për ASK-në dhe jo vetëm, ka qenë sfidues nga pikëpamja e angazhimit shtesë për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara me planin e punës të vitit 2023, përfshirë parapërgatitjet për projektin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë. Megjithëkëtë krahas përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë, ASK dhe i tërë stafi i saj, janë angazhuar maksimalisht për të arritur qëllimet e përcaktuara në planin vjetor te punës 2023 bazuar në objektivat e vendosura në programin e statistikave zyrtare 2018-2023. Ne anën tjetër ASK, është përballuar me sfida të shumta në zhvillimin e statistikave të reja (si statistikat sektoriale, llogaritë regjionale, tabelat ofruese – përdoruese, etj.) dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese nga vështirësia e krijuar me zvogëlimin e stafit përmes procesit të pensionimit dhe pamundësia për zëvendësimin e pozitave të lira dhe rekrutimin e atyre të reja të domosdoshme për zhvillimin dhe zgjerimin e hulumtimeve të reja. Ky dokument gjegjësisht raport paraqet arritjet e realizuara, produktet dhe publikimet e realizuara si dhe zhvillimet tjera në fusha të ndryshme gjatë vitit 2023.

Si rezultat i kërkesës për të dhëna të reja dhe një kohë më të shkurtër për shfrytëzuesit, ASK, në vazhdimësi ishte angazhuar për gjetjen dhe ofrimin e zgjidhjeve të reja teknike dhe operative. Disa publikime, realizimi i te cilave ishte në baza tremujore u publikuan në baza mujore. Gjithashtu u zhvilluan aktivitete intensive në lidhje me sigurimin e funksionimit dhe përmirësimin e procesit të mbledhjes së të dhënave përmes metodave CATI dhe CAWI. Në aspektin e mirëqeverisjes dhe efikasitet të brendshëm në ASK, ka vazhduar procesi i fuqizimit të veglave për rritje të efikasitetit dhe modernizimit të proceseve komunikuese si intraneti me modalitete të ndryshme operative si platforma “share point” me qëllim të rritjes së komunikimit dhe informimit të brendshëm në ASK për të gjithë stafin e saj.

Me qëllim të realizimit të misionit dhe vizionit të saj, ASK, ka bashkëpunuar dhe koordinuar aktivitetet për qasjen e saj në burime të ndryshme administrative. Megjithatë gjatë vitit 2023, ASK-ja, është ballafaquar me sfida në qasje në burimet ekzistuese si doganat dhe ATK, pra ne qasjen e të dhënave administrative. Në anën tjetër ASK, ka arritur që të ketë (sigurojë) qasje në të dhënat e Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës (AVUK), për të dhënat e blegtorisë, të cilat ndihmojnë cost efektivitetin dhe shkurtimin e kohës në përpunimin dhe publikimin e tyre. ASK është duke i shfrytëzuar të dhënat e AVUK-ut dhe ARC që nga TM2/2023 për qëllime statistikore.

Siç është cekur fare në fillim, projekti i Regjistrimit të Popullsisë ishte një ndër prioritetet e Qeverisë dhe ASK-së. Andaj procesit të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë, i është kushtuar vëmendje dhe përkushtim maksimal me qëllim të realizimit të gjitha aktiviteteve të parapara me planin e punës dhe dinamikën kohore. Si rrjedhojë, aktivitete të shumta dhe të rëndësishme janë realizuar deri në fund të vitit 2023 edhe përkundër sfidave që ishin në sigurimin e pajisjeve teknologjike dhe ato me resurse njerëzore. Ndër të tjera vazhdimi i koordinimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2023, komunikimi gjegjësisht sensibilizimi i opinionit, të gjerë përfshirë takimet të shumta me Institucione qendrore dhe ato lokale për të bashkërenduar aktivitetet. Në aspektin e mekanizmave menaxhues ka vazhduar koordinimi në nivel të Komisionit qendror të regjistrimit të popullsisë dhe komisioneve komunale të regjistrimit si dhe janë mbajtur takime të nevojshme.

Në fushën e bashkëpunimit dhe përkrahjes ndërkombëtare, ASK, është mbështetur me një numër të caktuar pilot projekte statistikore nga Eurostat në kuadër të PSHP (MBP) IPA 2019. Megjithatë menaxhimi apo ekzekutimi i fondeve të programit shumë përfitues IPA 2019, dedikuar për Pilot Projekte Statistikore dhe ngritje të kapaciteteve tekniko profesionale të ASK-së, se nuk është ekzekutuar si rezultat i mungesës së kornizës (rregullat-ivës ligjore). Auditimi i fundit nga ZAP, ka treguar se ASK, është në mesin e institucioneve me numër te vogël respektivisht gjetje minore në trajtimin e fondeve publike dhe atyre evropiane.

Përveç publikimit të rregullt, të Statistikave Zyrtare, ASK-ja, ka në politiken e saj edhe rishikimin e të dhënave krahas evoluimit të faktorëve të tjerë.

ASK-ja gjatë vitit 2023 ka bërë ndërrimin e vitit bazë të Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi nga 2015=100 në 2022=100 që është në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostatit. Gjithashtu janë përgatitur publikime eksperimentale/testuese, Statistika, të cilat zakonisht janë zhvilluar apo zhvillohen për herë të parë ose janë ende në fazën e zhvillimit dhe vlerësimit në drejtim të harmonizimin, mbulimin ose metodologjinë.

ASK, ja gjatë vitit raportues përveç tjerash është angazhuar edhe në rritjen e promovimit gjegjësisht ofrimit të të dhënave Statistikore Zyrtare të shfrytëzuesit e ndryshëm si dhe intensifikimin e prezencës se saj në mediat sociale përmes postimeve në kanalet zyrtare, sidomos në faceboook dhe mënyrat tjera të komunikimit me shfrytëzuesit institucional dhe me gjerë.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërinstitucional, ASK në bashkëpunim me Institucionet tjera të Republikës së Kosovës, ka vazhduar me përtëritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Punësimit për angazhimin e personelit (në pritje të angazhimit) nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës. Andaj përmes kësaj marrëveshje edhe gjatë vitit 2023, janë angazhuar mesatarisht rreth 80-90 regjistrues për muaj në mbledhjen e të dhënave nga tereni dhe më shumë për projektin e Regjistrimit të Popullsisë.

Si rezultat i angazhimeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të realizuar qëllimet e Planit Vjetor të Punës 2023, ASK në fund të vitit 2023, ka arritur të realizoj 82 produkte statistikore dhe 213 raporte statistikore të publikuara, 203 prej tyre janë realizuar në kohë, duke përmbushur mbi 95% të Programit të hulumtimeve statistikore.

Fig. 1. Numri i Publikimeve 2023, krahasuar me vitin 2022



Burimi: *te dhënat nga SIPK-ASK*

Nga pikëpamja mandatore, përgatitja e Raportit Vjetor të Punës për vitin 2023 dhe dërgimi i tij në Qeveri dhe Kuvend është i bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare (LIGJI Nr. 04/L-036, si dhe LIGJI NR. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e LIGJIT Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës). Në raport janë prezantuar të gjitha aktivitetet kryesore, të realizuara sipas Planit të Punës të vitit përkatës 2023. Informatat e prezantuara në këtë Raport kanë për qëllim ta mbajnë të informuar përdoruesin, institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, për të arriturat dhe sfidat e Sistemit Statistikor të Kosovës, gjatë vitit 2023.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, ASK ka arritur të rris numrin e publikimeve statistikore si rezultat i kalimit të shumë publikimeve nga frekuenca me baza tremujore në ato mujore.

Rekomandimet “Peer Review”, ASK-ja, duke u bazuar në vlerësimin e Sistemit Statistikor të Kosovës "Peer Review 2017", ka vazhduar me zbatimin e Planit të veprimit, i cili është, duke u monitoruar në vazhdimësi nga ASK-ja dhe Eurostati. Në raportin e fundit i cili përfshin periudhën kohore janar 2022-dhjetor 2022, nga gjithsej 21 veprime janë zbatuar 18 prej tyre apo 86%. Nga tri masat e mbetura dy prej tyre janë jashtë mundësive te ASK-se, si bie fjala shtimi i resurseve njerëzore. Raporti është dërguar në Eurostat në fillim të vitit 2023.

Publikimet e realizuara, gjegjësisht rezultatet e publikimeve janë shpërndarë në formën online në faqen zyrtare të ASK-së, duke respektuar Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP) për paanshmëri dhe objektivitet në qasjen e të dhënave për të gjithë shfrytëzuesit. Publikimet dhe të gjitha të dhënat tjera janë të postuara në Web faqen zyrtare të ASK-së: [http://ask.rks- gov.net/](http://ask.rks-gov.net/)



1. PERFORMANCA E ASK-së

Disa nga zhvillimet më të rëndësishme në kuptimin e përformancës gjatë vitit 2023, janë listuar si

më poshtë:

- Rritja e nivelit të përputhshmërisë me EU Acquis, në fusha të caktuara statistikore (CoP);
- Shkurtimi i afateve kohore në publikimin e BPV në baza vjetore dhetremujore;
- Shkurtimi i afateve kohore në publikimin e rezultateve të TIK në Ekonomitë Familjare
- Fillimi i hulumtimeve të reja statistikore, si : Llogaritë Kombëtare, Llogaritja e Produktit të Brendshëm Bruto me qasjen e të Ardhurave u publikua në javën e fundit të vitit 2023,(si eksperimentale), Llogaritë Regjionale, Llogaritë Sektoriale, u publikua në javën e fundit të vitit 2023, (si eksperimentalë). Vlerësimi i Ekonomisë Joformale, etj.;
- Rritja e vëllimit dhe cilësisë së të dhënave statistikore;
- Rritja e vëllimit të përshkrimit të produkteve statistikore - meta data për Statistika Zyrtare;
- Rritja e numrit apo vëllimit të të dhënave dërguar në Eurostat;
- Rritja e nivelit të përputhshmërisë në fusha me prioritet të dhënave statistikore përmes sistemit SMIS+;
- Rritja e numrit të publikimeve (dy publikime te reja të publikuara për herë të parë);
- Rritja e numrit të raporteve të cilësisë (4 sosh);
- Rritja e kapaciteteve njerëzore, administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Rritja dhe forcimi i rolit të ASK-së në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës;
- Zbatimi i rekomandimeve nga raporti “Peer Review për intervalin kohor: Janar 2023-Dhjetor 2023”
- Roli dhe kontributi i ASK-së në procesin OZHQ në Kosovë;
- Përgatitjet për Regjistrimin e Popullsisë (freskimi i Qarqeve Regjistruese, Projekt Propozimi i Përgatitur, Plani Financiar, etj.);
- Ligji për Regjistrimin e Popullsisë i aprovuar në Qeveri.
- Modernizimi i web faqes së ASK-së, me qasje të lehtë dhe shumë funksionale.
- Kalimi nga publikimet Tre Mujore ne ato Mujore,

Performanca 2023

- shkurtim i afateve kohore (për produkte krahasuese);
- 41 me shume publikime statistikore në 2023>2022;
- 90% zbatimi i planit te veprimit nga Peer Review;
- 112 aktivitete trajnuese, 172 pjesëmarrës

1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë

Fushat e përgjegjësisë në prodhimin e Statistikave Zyrtare për ASK-në, dhe për anëtarët e tjerë të Sistemit Statistikor të Republikës së Kosovës, janë të rregulluara me Ligjin mbi Statistikat Zyrtare Nr. 04/L-036 dhe Ligjin Nr. 06/l-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe aktet tjera përkatëse nënligjore. Zhvillimi dhe dinamika e aktiviteteve statistikore në arenën ndërkombëtare është mjaft e lartë e cila pashmangshëm ndër vepron edhe në Sistemin Kombëtar statistikor të Kosovës. Në këtë rrafsh korniza ligjore është përcaktuesi kryesor i ndryshimeve brenda sistemit Statistikor, ASK, ka vazhduar me implementimin e aktiviteteve si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore te mëparshme.

Gjatë vitit 2023, ASK, në bashkëpunim me Institucionet tjera të Republikës së Kosovës, ka punuar në zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për REKOS duke bëre përgatitjet e nevojshme në përputhje me dinamikën dhe planin e veprimit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Pas, sfidave ne sigurimin e pajisjeve të nevojshme për regjistruesit, Qeveria e Kosovës me propozim

të ASK-së, nxjerr vendimin për ndryshimin e datës së regjistrimit të popullsisë në 05 Prill deri me 17 maj 2024 dhe me një vendim tjetër për zgjatje të afatit deri me 24 maj 2024.

Në aspektin e direktivave, rregulloreve e metodologjive, ASK përdor dhe zbaton brenda kornizës së përgjithshme të Eurostat, parimet e Kodit të Statistikave Evropiane (CoP), e cila është e mbështetur (lejuar) në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës e kjo e fundit në rregulloren Nr. 223/2009 mbi Statistikat Evropiane. Si rezultat apo qëllim është përafrimi me ACQUIS, gjegjësisht, përafrimit të Sistemit Statistikor të Kosovës, me atë të BE-së dhe fuqizimit të rolit koordinues të ASK- së brenda Sistemit Statistikor të Kosovës.

Aspektet ligjore 2023

- Aprovimi nga KQR i Rregullores për Punën e Komisionit Qendror të Regjistrimit;
- Aprovimi nga KQR i Rregullores për Punën e Komisionit komunal të Regjistrimit;
- Aprovimi nga Qeveria i UA për shitjen e te dhënave statistikore;
- Aprovimi nga Qeveria i UA për konfidencialitetin dhe ruajtjen e te dhënave statistikore
- Zbatimi i vendimeve të qeverise, në fushën e statistikave

Gjatë periudhës raportuese 2023, ASK ja, ka vazhduar me draftimin dhe kompletimin e dokumenteve te nevojshme duke respektuar rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (Rregullore Numri i aktit: MF-04/2017-RR, Institucioni, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve). Me qëllim të shpalljes publike për financim të OJQ lidhur me nxitjen dhe sensibilizimin e qytetareve të etnive të ndryshme në projektin e Regjistrimit të Popullsisë në mënyrë masive.

Bazuar në përgjegjësitë ligjore dhe Programin Afatmesëm të Statistikave Zyrtare 2024-2028 të Punës, Agjendën Evropiane si dhe në Programin Vjetor të Punës së Qeverisë, gjatë vitit 2023, janë hartuar dhe realizuar dokumente mjaft të rëndësishme për ASK- në, si në vijim; Plani Vjetor i Punës për vitin 2024, si instrument për zbatimin e Programit Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare 2024-2028; është bërë freskimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (pjesa e statistikave) 2024-2026; Raporti mbi Zbatimin e Rekomandimeve nga procesi “Peer Review 2017” për vitin 2023, Harta Rrugore 2024 në nivel të ASK-së, Raporti Vjetor i punës për vitin 2022, Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë (pjesa e ASK-së), Raportet e Monitorimit të PKIE-së në fushën e statistikave si dhe raporte të tjera të dërguara në Eurostat dhe Organizata tjera (SMIS+), pyetësorë me të dhëna, gjegjësisht vala e parë dhe vala e dytë, etj.)

1.2. Këshilli Statistikor

Gjatë vitit 2023, Këshilli Statistikor, ka mbajtur 4 takime sipas rregullores se brendshme për funksionim. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023, një nga pikat në nivel të lartë të agjendës ishte regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave duke dhënë sugjerime dhe rekomandime në këtë projekt kaq madhor dhe kompleks për ASK ne dhe jo vetëm. Gjithashtu në përputhje me Ligjin mbi Statistikat Zyrtare, këshilli ka përgatitur dhe dërguar raportin e punës se këshillit në Ministrinë Financave, Punës dhe Transfereve. Përveç tjerash, Këshilli Statistikor sipas Rregullores për funksionimin e tij, ka dhënë rekomandime lidhur me proceset e zhvillimit të Statistikave Zyrtare. Ka aprovuar dokumentin, Kriteret Statistikore për Anëtaret e Rinj të Sistemit Statistikor të Kosovës si dhe formimin e Bordit Koordinues për autoritet tjera kombëtare për Statistika, takimet e rregullta të KS mbahen çdo tre muaj. Vlen të theksohet se anëtaret e këshillit kanë një afat 5 vjeçar me mundësi vazhdimi në fund të vitit të kaluar 2023, ka përfunduar edhe mandati 5 vjeçar i anëtareve ekzistues të KS. Si rrjedhojë ASK ka qarkulluar kërkesën

për caktimin e anëtarëve të rinj, përveç MINT, të tjerët janë deleguar dhe kompletuar. Këshilli përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë institucionet kyçe, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile.

1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi

Bashkëpunimi me institucionet si motra në fushën e statistikave në veçanti me Eurostat, ka karakter shume dimensional, në aspektin e pranimit të përkrahjes në aktivitete horizontale (pjesëmarrja ne takime te shumta të nivelit teknik, si punëtori, takime në grup, trajnime, vizita studimore, et) dhe mbështetjes me pilot projekte statistikore në kuadër të programit MB IPA 2019. Stafi i ASK-së, me mbështetje të asistencës teknike në fusha të ndryshme statistikore ka arritur të konsolidoj njësitë në prodhimin e publikimeve ekzistuese statistikore dhe të lansoj publikime të reja si bie fjala statistikat e Llogarive Sektoriale dhe Regjionale, BPV me qasjen e të Ardhurave etj.

Përkundër faktit që ASK-ja, gjegjësisht Republika e Kosovës, nuk është anëtare e Sistemit Statistikor Evropian, ka marrë pjesë në të gjitha forumet e parapara me planin e veprimit të Eurostat të cilat përveç vendeve të Unionit Evropian përfaqësohen edhe vendet e Ballkanit Perëndimor përfshirë edhe ASK gjegjësisht Republikën e Kosovës. Dy forumet më të larta në të cilat përfaqësohet ASK janë PGSC i cili është i dedikuar për rritjen e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe DGINS i cili përveç vendeve të Bashkimit Evropian përfaqësohen edhe Drejtorët e Përgjithshëm (ekuivalent pozita e KE) e vendeve te Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i të cilave është rritja e bashkëpunimit dhe përkrahja në projekte të ndryshme statistikore dhe aspektet tjera strategjike.

Stafi i ASK, morën pjesë në 112 aktivitete me 172 pjesëmarrës të organizuara nga Organizata ndërkombëtare kryesisht nga Eurostat. Këto ishin kryesisht takime të rregullta të punëtorëve të ndryshëm si grupe punuese, konferenca, seminare, vizita studimore, trajnime dhe aktivitete tjera të organizuara nga Eurostat në selinë e saj ne Luxembourg e po ashtu edhe në vende tjera individuale të BE. Përveç stafit të ASK, në aktivitete të tilla ndërkombëtare përfshihen edhe stafi i BQK dhe ai nga Ministria e Punës dhe Transfereve gjegjësisht nga Thesari, për të cilat, ASK është koordinator i ngjarjeve të tilla brenda Sistemit Statistikor të Kosovës.

Përkrahja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e Statistikave Zyrtare vazhdon të jetë i gjithanshëm, duke mbuluar pothuajse të gjitha fushat e Statistikave Sektoriale dhe më gjerë (ngritje e kapaciteteve përmes Pilot Projekteve, Trajnimeve, IT). Rritja e prodhimit (dy publikimet e reja të prodhuara për herë të parë) dhe përmirësimi i cilësisë së Statistikave Zyrtare është një ndër objektivat kryesore të ASK-së, të cilat përkojnë edhe me Strategjinë e Programit shumë përfitues të Komisionit Evropian, gjegjësisht Eurostatit për rritjen e përputhshmërisë së Statistikave Zyrtare me ACQUIS. Përafrimi i metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare në publikimin e Statistikave Zyrtare në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës paraqet boshtin e bashkëpunimit në mes të ASK së dhe Institucioneve Ndërkombëtare me theks të veçantë Eurostat-tin.

Si në çdo vit tjetër edhe në këtë vit raportues, Kosova respektivisht Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka arritur të realizojë një numër të konsiderueshëm të Projekteve Statistikore në kuadër të programit shumë përfitues IPA 2019 me qëllim të ngritjes së kapaciteteve tekniko profesionale të ASK-së, përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit përmes formës virtuale si takime, konsultime, ofrim i ekspertizës etj.

Fushat tjera sektoriale të cilat gëzojnë përkrahje të vazhdueshme janë: Statistikat Makro-ekonomike, siç janë Llogaritë Kombëtare, Statistikat e Çmimeve, Statistikat e Financave Qeveritare, Paritetit të Fuqisë Blerëse, Ekonomia Joformale, etj. Ndërsa në fushën e Statistikave Sociale, Statistikat e Tregut të Punës, Statistikat në të Ardhurat dhe Kushtet e Jetës (SILC), Statistikat e Arsimit, Statistikat e Popullsisë, Anketa për Teknologjinë Informative (ICT) etj. Në fushën e Statistikave të Biznesit i është kushtuar vëmendje Anketës Strukturore të Bizneseve, Statistikave Afatshkurtra, Statistikave të Energjisë, Transportit, etj. Në

fushën e Statistikave të Bujqësisë, në fokus të bashkëpunimit kanë qenë Llogaritë Ekonomike për Bujqësi, Statistikat e Kulturave Bujqësore Bimore, Statistikat e Blegtorisë dhe Prodhimeve Blegtorale si dhe aktivitetet për ndërrimin e vitit bazë të Indeksit të Çmimeve në Bujqësi nga 2015=100 në 2022=100. Jo më pak rëndësi i është kushtuar edhe Statistikave të Tregtisë Ndërkombëtare, Statistikat e TIK (ICT) në nivel të Bizneseve, pasuar me Regjistrat Statistikor, si Regjistri i Bizneseve, Regjistri i Bujqësisë, Llogaritjeve Mjedisore, etj.

Në anën tjetër në aspektin bilateral ASK, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Ambasadës Suedeze në Prishtinë, janë akorduar për draft hartimin e projekt propozimit për përkrahje të ASK-së për periudhën 2024-2028 financuar nga agjencia suedeze SIDA. Përmes këtij projekti janë paraparë komponentë të veçanta në konsolidimin e tyre të mëtejshëm duke bartur përvojat dhe praktikat më të mira sipas metodologjisë së Eurostat-it. Po ashtu është nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me projektin regjional SIDA për angazhimin e stafit në mes të vendeve të rajonit varësisht nga përparësitë teknike profesionale në fushat përkatëse.

Në rrafshin e brendshëm - edhe përkundër progresit të shënuar në vitet e fundit me mundësinë e qasjes në burimet administrative të të dhënave në ARC dhe AVUK, në anën tjetër kemi pasur pengesa (si rezultat i ndryshimit te kornizës ligjore) në qasjen e të dhënave të ATK-së dhe Doganave te Kosovës të cilat kanë pamundësuar publikimin e të dhënave në kohë për Statistikat e Tregtisë së Jashtme dhe ato të Tregut të Punës bazuar në të dhëna administrative. Koordinimi ndër Institucional është më së i domosdoshëm në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës, për të subordinuar dhe lehtësuar ASK-së qasja në burime administrative duke plotësuar parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane si dhe duke e rritur cost efektivitetin në prodhimin statistikor. Orientimi strategjik i ASK-së, është që sa më shumë që është e mundur të përdor të dhëna bazuar në burime administrative duke mundësuar shkurtimin e afateve kohore deri në publikimin e tyre, ulë koston e prodhimit si dhe duke rritur cilësinë të dhënave Zyrtare Statistikore. Andaj siç është cekur edhe më lartë mundësia për qasje në këto burime përveç përfitimit të vetë procesit të prodhimit statistikor ndikon edhe në mirëqeverisjen gjegjësisht ndikon ne cost efektivitetin e aktiviteteve si një ndër parimet e statistikave evropiane CoP.

Bashkëpunimi me komunitetin e botës akademike - Pas ciklit të takimeve me botën akademike gjatë vitit 2022, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së përvojave praktike nga ana e ASK-së dhe sigurimin e mbështetjes dhe kërkimit ë përbashkët shkencor në fusha të veçanta sidomos ato me kërkime dhe prezantime me interes të përbashkët ndërkombëtar. Gjatë vitet 2023, këto iniciativa janë diskutuar dhe mirëmbajtur me qëllim të gjetjes së formave dhe mënyrave për bashkëpunim të përbashkët kombëtar. Krijimi i një Programi Master në fushën e Statistikave në kuadër të Fakultetit Ekonomik mbetët synim kryesor megjithëse tani për tani ka sfida në akreditimin e këtij programi nga fakti i vështirësive në plotësimin e kritereve bazë (mungesa e personelit akademik me titull phd në fushën e Statistikave). Për këtë qëllim përmes një vizite pune të realizuar në Fakultetin Ekonomik të Tiranës dhe INSTAT janë shqyrtuar dhe analizuar praktikat më të mira në zbatimin dhe funksionalizimin e Programit Master në Statistika në fakultetin Ekonomik të Prishtinës.

Komunikimi - ASK, vazhdon ta përdor Web faqen e saj si kanal kryesor komunikimi gjegjësisht shpërndarjen e të dhënave zyrtare të shfrytëzuesit. Përmes veglës Google Analytics, janë regjistruar 329,887 shikime, shkas për rritjen e një numri kaq të madh krahasuar me vitin paraprak është ridizajnimi i Web faqe se ASK-së konkretisht mundësia për të kërkuar emrat në Kosovë. Ndërsa nga fushat sektoriale interesimi më i madh ishte për të dhënat respektivisht publikimet e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare ndjekur nga të dhënat për punësimin.

ASK-ja ka krijuar formën elektronike përmes formularit elektronik në web-faqe e ASK-së për kërkesat e tyre, si dhe për media si dhe vazhdon ta mirëmbaj këtë formë komunikimi në mënyrë që shfrytëzuesit të jenë të furnizuar me të dhëna statistikore. Po ashtu, kujdes i veçantë i është kushtuar popullimit me informata të reja të përmbajtjes së ueb-faqes së ASK- së, dhe mediave sociale (Facebook). Sa i përket numrit të personave që përcjellin faqen zyrtare në rrjetet sociale facebook, Kosova respektivisht ASK renditet me numrin më të madh të ndjekëseve në raport me numrin e banorëve në vendet e rajonit tonë.

Me gjithë sfidat që janë paraqitur kohë pas kohe, përdoruesit e Statistikave Zyrtare, në mënyrë të vazhdueshme, janë informuar për të dhënat më të fundit statistikore, duke shtuar edhe publikimet mujore. Në anën tjerët, komunikimi me media ka vazhduar rrjedhën e bashkëpunimit të mirëfilltë, duke rritur kontaktet me gazetarë, si dhe duke rritur numrin e intervistave në media, ku paraqitjet stafit të ASK-së në TV dhe Radio është rritur. Kontaktet me përdorues (qofshin institucione publike, universitete publike e private, organizata vendore a ndërkombëtare, ose individ), kanë vazhduar duke shfrytëzuar instrumente dhe metoda të ndryshme, qoftë përmes platformave elektronike, adresës zyrtare, kerkesa me shkrim, intervistave përmes telefonit, xhirimeve me kamerë, dhe përmes mediave sociale.

Monitorimi është bërë përmes platformës “Google Analytics”, andaj në vitin 2023 krahasuar me vitin paraprak, numri i vizitorëve ka shënuar ngritje nga sa ishte 142812 në vitin 2022 ne 329,887 ne vitin 2023.

Rritja dhe zhvillimi i ueb-it dhe teknologjisë së ndërlidhur ka ndryshuar mënyrën, që përdoruesit presin për t’u qasur në Statistikat Zyrtare. ASK në vazhdimësi është duke punuar në mënyrë që të dhënat zyrtare të statistikave të jenë sa më lehtë të qasshme dhe të kapshme për të gjithë shfrytëzuesit. Në vijim përmes formës tabelore janë paraqitur numri i vizitorëve në faqen zyrtare të saj sipas viteve 2021-2023.

Fig. 1: Numri i vizitoreve në Web faqen e ASK-se, 2021-2023



Burimi: *ASK/platforma google analytics*

Nga te dhënat e prezantuara në grafikun e mësipërm, shihet se gjate vitit 2023, numri i shikimeve gjegjësisht vizitorëve në ueb faqen e ASK-së, ka shënuar rritje prej 231%, rritja në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ishte 51.7%.

1.4. Llogaritë Kombëtare

Llogaritë kombëtare si një ndër fushat me treguesit makro ekonomik të rëndësishëm për Institucionet vendimmarrëse edhe gjatë vitit 20223, është shënuar progres i dukshëm në zbatimin e metodologjisë së Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010, në bazë të së cilës është bërë edhe publikimi i Statistikave të Llogarive Kombëtare. Të gjitha publikimet janë kryer me kohë sipas Planit dhe Kalendarit të Publikimeve.

Gjatë periudhës referuese në fushën e Statistikave të Llogarive Kombëtare janë publikuar:

Në baza tremujore:

- Bruto Produkti Vendor (BPV), me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve, për tremujorët (TM4/2022- TM3/2023);

Në baza vjetore:

- Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve për vitin 2022; Pas çdo publikimi vjetor ose tremujor, te dhëna janë dërguar në Eurostat përmes platformës SDMX;
- Numri i tabelave me te dhëna te dërguara ne Eurostat është rritur dukshëm dhe kjo rritje vazhdon derisa të përmbushen të gjitha kërkesat e Eurostatit.

BPV 2023

- Të dhënat vjetore të BPV për vitin 2023 publikohen në shtator 2024. BPV per vitin 2022 është 3.51%

Aktivitete tjera të realizuara

- Përveç aktiviteteve te rregullta, në fushën e Statistikave të Llogarive Kombëtare, ASK, ka përpiluar edhe tabelat ofruese-përdoruese (SUT);
- Janë përllogaritur dhe dërguar të dhënat e BPV-së në baza tremujore sipas lidhjeve zingjirore dhe efekteve se-zonale;
- Ka vazhdua përllogaritja e Bruto Produkti Vendor sipas qasjes së të Ardhurave (eksperimentale);
- Llogaritë regjionale, Llogaritë Sektoriale, u publikuan në javën e fundit të vitit 2023, (si eksperimentalë);
- Vlerësimi i Shpenzimeve të Konsumit Final të Ekonomive Familjare sipas qëndrueshmërisë, me Çmime Aktuale;
- Përpilimi i Llogarive Sektoriale jo-financiare vjetore;
- Është përditësuar "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të Llogarive Kombëtare vjetore me Çmime Aktuale;
- "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të Llogarive

Të hyrat Qeveritare 2023

- Të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme për vitin 2023 ishin 2,860.7 milion Euro;
- Tatimet në produkte, paraqesin 72% të totalit të të hyrave.

Kombëtare vjetore me Çmime të vitit të kaluar";

- "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të Llogarive Kombëtare - tremujore";
- "Përshkrimi i burimeve dhe metodave të Llogarive Sektoriale jo - financiare vjetore";
- Përgatitja e raporteve fillestare për 4 projekte te IPA 2019:
- SP1.3 Metodologjia e Llogarive Kombëtare;
- SP1.4 Programi i transmetimit të të dhënave vjetore, tremujore, raporti i cilësisë;
- SP1.6 Llogaritë sektoriale jo-financiare;
- SP1.7 Tabelat ofruese-përdoruese (SUT);
- Përgatitja e tabelave monitoruese lidhur me aktivitetet në këto projekte;
- Është punuar në vlerësimin e investimeve sipas aseteve 2008-2023, mbështetur nga projekti IPA 2019;
- Vlerësimi i stoqeve 2018-2023;
- Është punuar në përgatitjen e tabelave: 0101, 0102, 0103, 0110, 0111, 0117, 0120, 0121, 0501, të cilat do të dërgohen në Eurostat këtë vit;
- Përgatitja e "Raportit të Cilësisë së Llogarive Kombëtare".

Në kuadër të Statistikave të Llogarive Kombëtare ASK, prodhon edhe të dhëna për **Statistikat e Llogarive Qeveritare dhe Ekonomisë Joformale.** Sipas Planit të Punës 2023 të gjitha aktivitetet e planifikuara me Planin e Punës 2023 janë realizuar dhe është shënuar progres i dukshëm për aktivitetet e mëposhtme.

Publikimet e realizuara për Statistikat e Llogarive Qeveritare si më poshtë:

Në baza tremujore:

- Llogaritë Qeveritare TM4 2022-TM3 2023

Në baza vjetore janë publikuar:

- Llogaritë Qeveritare për vitin 2023

Ka vazhduar **zbatimi i metodologjisë ESA 2010 për Statistikat** e Llogarive Qeveritare:

- Përpilimi i Tabelat e njëjta janë dërguar në Eurostat duke kontribuar ne përafrimin e Statistikave Zyrtare të tabelave 1, 2 dhe 3 të EDP-së (Excessive deficit procedure Llogarive Qeveritare me ACQUIS;
- Përgatitja e inventarit të metodave, procedurave dhe burimeve të përdorura për përpilimin e të dhënave të deficitit dhe borxhit dhe të Llogarive Qeveritare sipas ESA 2010;
- Përgatitja e tabelave të njoftimit për EDP dhe dërgimi në Eurostat;

Përpilimi i tabelave për financat e Llogarive Qeveritare dhe dërgimi në Eurostat:

- Tabela ESA 0200 - Agregatet kryesorë të Qeverisë së Përgjithshme;
- Tabela ESA 0900 - Tatimet e detajuara dhe kontributet sociale sipas llojit të tatimit;
- Tabela ESA 1100- Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme sipas Funksioneve;

- Tabela ESA 2500 - Llogaritë jo Financiare tremujore për Qeverinë e Përgjithshme;
- NTL - Lista e detajuar e taksave dhe kontributeve sociale sipas klasifikimit kombëtar;
- Gjatë vitit 2023 është shënuar progres i dukshëm lidhur me Statistikat e Ekonomisë Joformale, duke përfshirë;
- Vlerësimi i Ekonomisë Joformale për tipin N6 – Prodhuesit që qëllimisht nuk raportojnë për të punësuarit me dhe pa punonjës për periudhën 2011-2023;
- Vlerësimi i trafikimit të drogës 2008-2023;
- Ekstrapolimi i të dhënave të Ekonomisë Joformale në bazë të kontrolleve të auditimit fiskal 2017-2019.

Siç është cekur më lartë bashkëpunimi me partnerë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 përmes platformës virtuale, përveç në fusha tjera edhe në fushën e Llogarive Kombëtare, projekti EU/SIDA ka ndihmuar në përmirësimin Llogarive Kombëtare dhe Ekonominë Joformale. Burimi i të dhënave për statistikat qeveritare janë nga thesari i Republikës së Kosovës

Shpenzimet Qeveritare 2023

- Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme ishin 2.925,5 milion Euro;
- Kompensimi i punëtorëve përbën 26%, të shpenzimeve të përgjithshme.

e

1.5. Statistikat Ekonomike

Gjatë vitit 2023 në fushën e Statistikave Ekonomike janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, sipas planit dhe dinamikës së paraparë. Gjate kësaj periudhe, ka pasur stabilitet në numrin e produkteve statistikore dhe shkurtim të afateve kohore të publikimeve.

Gjatë vitit 2023, gjashte (6) publikime tremujore kane kaluar ne publikime mujore, si dhe janë përcjelle dhe publikua ne ueb-faqen e ASK-se.

Publikimet e realizuara gjate vitit 2022 ne fushën e Statistikave ekonomike.

Në baza vjetore:

- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, 2022;
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) (2022);
- Bilanci i Energjisë në Kosovë (2022);
- Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (2022);
- Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it (2022);
- Statistikat e Hotelerisë 2022;

- Rezultatet e Anketës për Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikim në Ndërmarrje (ICT) 2022 dhe;
- Rezultatet e Anketës së Investimeve në Ndërmarrje (2022).

Në baza tremujore:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP), për periudhën TM4/2022-TM3/2023;
- Indeksi i Çmimeve të Importit (IÇIMP) për periudhën TM4/2022-TM3/2023;
- Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) për periudhën TM4/2022-TM3/2023;
- Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike, për periudhën TM4/2022-TM3/2023

Inflacioni 2023

- Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2023 ishte 4.9%. Në vitin 2022 norma mesatare e inflacionit ishte 11.6%

Në baza mujore:

- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, për periudhën dhjetor 2022-nëntor 2023
- Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) për periudhën dhjetor 2022-nëntor 2023;
- Statistikat e Transportit, për periudhën Janar 2023-Tetor 2023;
- Statistikat e Hotelerisë, për periudhën Nëntor 2022-Nëntor 2023;
- Statistikat e Energjisë, për periudhën Nëntor 2022-Tetor 2023;
- Statistikat e Industrisë bashkë me Indeksin e Vëllimit Industrial për periudhën Tetor 2022-Shtator 2023;
- Statistikat e Tregtisë me Pakicë, për periudhën Tetor 2022-Shtator 2023, dhe
- Statistikat e Shërbimeve, për periudhën Tetor 2022-Shtator 2023

Tregtia e jashtme

Kosova gjatë vitit 2023:

- Eksportoi: 863,141,000 EUR;
- Importoi: 5,917,027,000 EUR;
- Bilanci tregtar: (5,053,886,000) EUR;
- Mbulimi 14.6%

Statistikat e tregtisë së jashtme tregojnë se ka një hendek të thelle në mes të eksportit dhe importit ne disfavor të së parës. Nga të dhënat e publikuara shihet se një 1 Euro eksport kemi raportin me 6.6 euro import apo 1 euro import vetëm 0.15 uro cent eksport. Deficit tregtar më i lartë për 7,1% në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022.

Tregtia e mallrave në vitin 2023 kishte deficit tregtar në vlerë prej 5,1 miliard Euro, që tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për (7,1%) krahasuar me vitin 2022, ku edhe në këtë vit kemi bilanc negativ. Totali i eksporteve në këtë vit ishte 863,1 milion Euro, ndërsa importi 5,9 miliard Euro. Eksporti mbulon importin për vetëm 14.6%.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 22.30% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 17.66% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 13.86% e përbëjnë

plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10.52% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 6.52% e përbëjnë produktet minerale; 4.77% e përbëjnë tekstil dhe artikuj tekstili; etj.

Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 14.57% e përbëjnë produktet minerale; 12.14% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.44% e përbëjnë makineria dhe pajisjet mekanike dhe elektrike; 10.00 e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9.99 e përbëjnë mjetet e transportit; 6.92% e përbëjnë produktet e industrisë kimike; etj.

Të dhënat e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit janë transmetuar në baza mujore në Eurostat në platformën SDMX, gjithashtu transmetohet në baza të rregullta mujore në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) në GDDS (General Data Dissemination System), kurse Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në baza tremujore transmetohet në FMN.

Në fushën e Statistikave të Bizneseve dhe të Tregtisë së Jashtme, janë realizuar publikimet sipas titujve të ndryshëm në baza mujore, tremujore dhe vjetore.

Në tërësi, në fushën e Statistikave Ekonomike janë publikuar gjithsej 110 raporte statistikore në përputhje me kalendarin e publikimeve. Krahasuar me vitin 2022 (107 raporte), +3 raporte me shumë apo një rritje prej 3% Gjatë vitit 2023 ka pasur një rritje të shfrytëzimit të të dhënave administrative për publikimet e Statistikave Ekonomike.

Numri i bizneseve dhe Investimet

- Në vitin 2023 janë regjistruar 11,422 ndërmarrje të reja;
- Ndërsa janë shuar 1 617 ndërmarrje;
- 99.2% të ndërmarrjeve, kane përdorur kompjuterin dhe 97.1% internetin;
- Investimet Private në vitin 2023, ishin 1,136,988,425 € prej tyre Investimet në ndërtim zënë peshën kryesore, me 53.03 %.

1.6. Statistikat Sociale

Statistikat Sociale mbulojnë aspekte të ndryshme të të dhënave socio-ekonomike si Statistikat e Tregut të Punës, Pagave, Arsimit, Shëndetësisë, të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës, Shpenzimeve të Buxhetit të Ekonomive Familjare, Mirëqenies Sociale, Statistikave të Jurisprudencës, Kulturës si dhe Përdorimit të Teknologjisë Informative në Ekonomitë Familjare dhe Statistikave të Popullsisë.

Objektivi i ASK-së, në këtë rrafsh është që përmes të dhënave zyrtare (Statistikave Sociale) në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikor, të ndihmojë institucionet vendimmarrëse në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqenies shoqërore në vend.

ASK, është duke u përpjekur në shkurtimin e afateve kohore aq sa është e mundur për ofrimin e të dhënave të shfrytëzuesit sa me shpejte që të jetë e mundur.

Gjatë vitit 2023 është shënuar progres në shkurtimin e afateve kohore tek disa publikime si dhe në ngritjen e cilësisë së të dhënave të Statistikave Sociale dhe të Popullsisë.

Aktivitete tjera të realizuara

Përveç aktiviteteve të rregullta të realizuara në kuadër të Statistikave Sociale dhe të Popullsisë, gjithashtu

janë realizuar edhe një sërë aktivitete tjera të përkrahura nga IPA 2019 me qëllim, ngritjen e kapaciteteve profesionale të ASK dhe njehe-rit rritjen e numrit të indikatorëve përveç përdorimit nga Institucionet vendore dërgohen edhe në Eurostat.

Në baza mujore janë publikuar:

- Statistikat e Mirëqenies sociale për muajt dhjetor 2022 dhe Janar-Nëntor 2023;
- Statistikat Administrative e Tregut të Punës për muajt dhjetor 2022 dhe Janar-Nëntor 2023;
- Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve (Nëntor-Dhjetor 2022 dhe Janar-Tetor 2023).

Në baza 3 mujore janë publikuar:

- Rezultatet e Anketës se Fuqisë Punëtore TM1-TM4 2022

Në baza vjetore janë publikuar:

- Rezultatet e Anketës se Fuqisë Punëtore 2022;
- Rezultatet e Anketës SILC 2022;
- Rezultatet e Anketës TIK ne Ekonomi Familjare 2023;
- Niveli i Pagave 2022;
- Statistikat e Arsimit 2022/2023;
- Statistikat e Arsimit të Lartë sipas Fushave të Studimit 2022/2023;
- Statistikat e Shëndetësisë 2022;
- Statistikat e Kulturës 2022;
- Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2022;
- Statistikat e Lindjeve 2022;
- Statistikat e Vdekjeve 2022;
- Vlerësimi i Popullsisë 2022;
- Statistikat e Kurorëzimeve 2022;
- Statistikat e Shkurorëzimeve 2022;
- Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë 2023.

Gjatë vitit 2023 për herë të parë janë publikuar Rezultatet e Anketës e Kostos së Punës 2022 si dhe Rezultatet e Anketës Dhuna në Baza Gjinore 2023/2022.

Gjithashtu është shënuar një progres tek publikimi i Statistikave të Kulturës ku për herë të parë sipas rekomandimeve nga Eurostat-i, përpos burimeve administrative të të dhënave janë shfrytëzuar edhe burimet nga anketat e ndryshme në ASK duke rritur numrin e treguesve të Kulturës.

Krahas progresit ka pasur edhe sfida të cilat janë përcjellë me vonesa dhe mos realizim gjegjësisht publikime të cilat kanë qenë pjesë e Planit Vjetor 2023 të cilat kanë ardhur si pasojë e mos-raportimit të të dhënave nga Institucionet përkatëse (Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe Federatat e Sporteve), qoftë nga vonesat e paraqitura në grumbullimin e të dhënave-vonesat në publikimet e AFP-së.

Statistikat Vitale

Në Kosovë gjatë vitit 2023 janë regjistruar:

- Lindje 31,110 fëmijë;
- Vdekje 11,121 persona;

- Kurorëzime 16,978 raste;
- Shkurorëzime 2,212 raste.

Aktivitete tjera të realizuara:

Gjatë vitit 2023 është zhvilluar Pilot Anketa e Arsimimit të të Rriturve (AES) si dhe kanë vazhduar aktivitetet përgatitore per zhvillimin e Anketës së plotë e cila do të zhvillohet gjatë vitit 2024.

Gjithashtu janë zhvilluar aktivitete përgatitore (përgatitja e pyetësorit dhe udhëzuesit si dhe aplikacionit në CAWI) për fillimin e Anketës së Strukturës së të ardhurave nga puna (SES) e cila pritet të zhvillohet për herë të parë gjatë vitit 2024**.** Gjithashtu përmes dy ad-hoc misioneve në kuadër të IPA 2019 janë zhvilluar disa aktivitete për klasifikimin e skemave të mbrojtjes sociale sipas sistemit ESSPROS.

Regjistrimi i Popullsisë - pas aprovimit të Ligjit nga Kuvendi i Kosovës në muajin Korrik 2022, në vitin 2023 me vendim te Qeverisë së Republikës së Kosovës, u caktua data e Regjistrimit të Popullsisë nga data 1 shtator deri me 16 tetor 2023.

Pas themelimit (tetor 2022) të organeve të Regjistrimit të Popullsisë (KQR, KKR), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka zhvilluar aktivitete te ndryshme përgjatë vitit 2023 si me poshtë:

- ASK ka zhvilluar testin e III me qëllim për të kontrolluar transmetimin e të dhënave në data bazë;
- Janë zhvilluar 84 takime të ndryshme me shfrytëzues të të dhënave;
- Është dra-ftuar versioni final i pyetësorëve dhe udhëzueseve;
- Janë dixhitalizuar hartat (në sistemin e GIS në data bazë);
- Janë, siguruar tabletë dhe laptopë;

Regjistrimi i Popullsisë

- Finalizimi i pyetësorëve;
- Finalizimi i udhëzuesve;
- Rekrutimi i stafit per teren (ToR 5000 persona);
- Sigurimi i pajisjeve per regjistrues dhe stafin tjetër;
- Digjitalizimi i hartave për teren;
- Testi i madh për Regjistrim.

- Janë kontaktuar te gjitha komunat e Kosovës rreth fushatës sensibilizuese dhe angazhimit të stafit si regjistrues dhe mbikëqyrës;
- Janë zhvilluar 3 video-animacioneve;
- Përgatitja e termave te referencës dhe shpallja e konkurseve për Regjistruesit dhe Mbikëqyrësit;
- Është organizuar java e Regjistrimit te popullsisë per 4 ditë me pjesëmarrjen e mbi 120 institucioneve kombëtare e ndërkombëtare;
- Është organizuar dhe zbatuar testi i dyte i madh i mënyrës se funksionit të sistemit;

Pas kërkesës së ASK-së, për ta rishikuar datën e Regjistrimit, Qeveria mori vendim që regjistrimi i Popullsisë në Kosovë të realizohej nga data 05 Prill 2024-17 Maj 2024.

Organet e Regjistrimit dhe vendimet

Projekti është organizuar dhe mbikëqyrur nën kujdesin e Qeverise, ndërsa organet si Komisioni Qendror i Regjistrimit, Komisionet komunale të Regjistrimit, ASK, bartëse operative si dhe nivele tjera të përfshira ne proces. Komisioni Qendror i Regjistrimit sipas kompetencave te saj ka nxjerre dy rregullore: Rregullorja për Komisionin Qendror te Regjistrimi dhe rregullorja për Komisionet Komunale te Regjistrimit. Gjithashtu janë nënshkruar MeM me Institucione tjera per nevoja të regjistrimit të popullsisë si dhe per për statistikat sektoriale me qëllim te bashkëpunimit dhe qasjen ne te dhëna administratave si bie fjala MeM e nënshkruar në mes Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK-së) për përpunimin e të dhënave për nevoja te Regjistrimit te Popullsisë dhe hartimit te Regjistrit Statistikor të Popullsisë.

1.7. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit

Në fushën e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe raportuese, është evidentuar progres në shkurtimin e afateve kohore të publikimeve, si dhe në përmirësimin e cilësisë dhe harmonizimin me metodologjitë e Eurostatit, sidomos në prodhimin e Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi, me vitin bazë 2022=100 dhe publikimi i dy publikimeve të reja në fushën e mjedisit.

Gjatë periudhës raportuese është bërë grumbullimi i të dhënave në terren dhe monitorimi i zhvillimit të Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB), përfshirë kontrollimin e cilësisë së grumbullimit të të dhënave të kësaj ankete. Të dhënat për AEB 2023, janë mbledhur me metodën "CAPI" duke i shfrytëzuar tabletat. Është përmirësuar aplikacioni për grumbullimin e të dhënave në teren për Anketën e Ekonomive Bujqësore 2023 pra janë shtuar më shumë rregulla të validitimit në aplikacion që mundësojnë cilësi më të mirë të grumbullimit të të dhënave në teren. Metoda "CAPI" përveç ndikimit në rritjen e cilësisë, gjithashtu është modernizim i procesit të grumbullimit të të dhënave dhe ka mundësuar që të dhënat e AEB 2023 të jenë në dispozicion për përpunim dhe analiza në kohë më të shkurtë duke eliminuar fazat tjera si kohën e përfshirjes së të dhënave në kompjuter siç ishte me pyetësorët në letër (metoda PAPI) dhe ka kosto më të lirë.

Në kuadër të Statistikave të Bujqësisë janë publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) 2022.

Ndërsa tek Statistikat Agro-monetare, në baza tremujore janë publikuar:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi (TM4/2022 dhe TM1-TM3/2023) si dhe Indeksi i Çmimeve të in puteve në Bujqësi (TM4/2022 dhe TM1-TM3/2023 me vitin bazë 2015 = 100.

Bujqësia 2023

- Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2023 ishte 420,688.21ha (205.75 ha) me shume krahasuar me një vit me pare;
- Tokë e punueshme – ara, në vitin 2023 ishte 188.435,31 ha (44.8%);
- Numri i gjedheve ishte 247,493 krerë;
- Numri i deleve ishte 207,123 krerë;
- Numri i dhive ishte 27,912 krerë;
- Numri i derrave ishte 43,686 krerë.

Në baza vjetore janë publikuar:

- Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi 2015 - 2022,
- Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi 2015-2022 dhe
- Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2022.

Të gjitha publikimet mbi Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi gjatë vitit 2023, janë publikuar me vitin bazë 2015=100 dhe është bërë monitorimi mujor i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore dhe përpunimi i tyre.

Mjedisi

- Në Kosovë për vitin 2022 janë grumbulluar gjithsej 488 mijë ton mbeturina komunale;
- Të dhënat e vitit 2022 tregojnë se mesatarja vjetore e mbeturinave komunale të grumbulluara ishte 275 kg për banorë;
- Ne vitin 2022 mesatarja ditore e mbeturinave komunale te gjen eruara ishte 0.75 kg/banorë.

Në fushën e Statistikave të Mjedisit gjatë vitit 2023 janë publikuar dy publikime të reja (për herë të parë). Këto janë:

- Taksat Mjedisore 2019 -2023 në Kosovë dhe
- Llogaritë e Emetimeve në ajër 2022.

Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA), 2020 - Rreth 75,0% të emetimeve të CO2 në 2020 u liruan nga sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar. Të dhënat nga ky publikim tregojnë se ndotësit (emetimet) më të mëdhenj të ajrit në Kosovë në vitin 2020 ishin: CO2 (8,409 Gg); CH4 (23,44 Gg); bio CO2 (3,338 Gg) dhe N2O (1,99 Gg).Lidhur me aplikimin e metodologjisë, si në fushat tjera sektoriale edhe në prodhimin e Statistikave të Bujqësisë, Agromonetare dhe të Mjedisit, ASK ka zbatuar rregulloret, metodat dhe udhëzimet sipas standardeve të Organizatave Ndërkombëtare, në veçanti ato të Eurostatit.

Në Statistikat e Mjedisit janë publikuar:

- Anketa e Mbeturinave Komunale 2022;
- Anketa e Mbeturinave Industriale 2022;
- Statistikat e Ujërave në Kosovë, 2022-2023
- Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2022.

Janë grumbulluar të dhënat nga burimet administrative për Statistikat e Ujërave, Statistikat e Ajrit, Fakte mbi Mjedisin dhe për Statistikat tjera të Bujqësisë dhe Mjedisit.

Në kuadër të përkrahjes së asistencës teknike (IPA 2019) nga Euorstat-ti, janë kryer disa aktivitete për dy Pilot Projekte, gjegjësisht për: Llogaritjet Mjedisore (Emisionet e Ajrit, taksat mjedisore dhe llogaritjet tjera mjedisore) dhe për statistikat e mbeturinave.

Indeksi i Çmimeve në Bujqësi

- Indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore në vitin 2023, u rrit për (13.1 %) krahasuar me vitin 2022.
- Indeksi i përgjithshëm çmimeve të inputeve bujqësore në vitin 2023 (Input 1 +Input 2) kishte rritje për 0.6 % krahasuar me vitin 2022.

1.8. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare

Përkrahja e Eurostat-it, për ASK-në, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 me Projekte Statistikore në fusha të ndryshme statistikore. Qëllimi i këtyre Pilot Projekteve është ngritja e kapaciteteve të stafit, me qëllim të rritjes së numrit të indikatorëve (të dhënave të reja) dhe përmirësimi i cilësisë së atyre ekzistuese.

Në vijim janë paraqitur titujt e Projekteve Statistikore të realizuara gjatë vitit 2023, të mbështetura nga Komisioni Evropian, në kuadër të programit IPA MB 2017 dhe 2019.

Titujt e Projekteve Statistikore në kuadër të IPA MB 2019:

Nr.		Përshkrimi
1.	1.1.	Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Deficitit të Tepërt
2.	1.2.	Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve (ITSS)
3.	1.3.	Metodologjia e Llogarive Kombëtare
4.	1.4.	Programi i transmetimit të të dhënave vjetore, tremujore, raporti i cilësisë
5.	1.6.	Llogaritë Sektoriale jo-financiare
6.	1.7.	Tabelat Ofruese-Përdoruese (SUT)
7.	2.1.	Harmonizimi I Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe Indeksi i Çmimit të Shtëpisë (ICSh)
8.	2.2.	Statistikat e Çmimeve
9.	3.1.	Regjistrat e Biznesit
10.	3.2.	Statistikat Afatshkurtra të Biznesit: përgatitja për FRIBS
11.	3.7.	Statistikat Strukturore të Biznesit (SSB) dhe Statistikat e Demografisë së Biznesit/BDB
12.	3.8.	Statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Mallrave (STNM)
13.	3.9.	Statistikat e Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) dhe Statistikat e GBAORD
14.	4.1.	Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)
15.	4.2.	Anketa e të Ardhurave (EU-SILC) – IPA 2017
16.	4.4.	Statistikat e Krimit dhe Drejtësisë Penale – IPA 2017
17	4.7.	Anketa mbi Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ); – IPA 2017
18	5.5.	Llogaritjet Mjedisore
19	5.6.	Statistikat e Mbeturinave
20	6.1.	Menaxhimi i Cilësisë
21	6.2.	Meta data
22	7.1.	Të dhënat burimore (bazë) të nevojshme për llogaritjen e procedurës së disbalancave makroekonomike (MIP)
23	8.1.	Raportimi i Aktiviteteve Horizontale

1.9. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative

Gjatë periudhës raportuese bazuar në Planin Vjetor të Punës në kuadër të proceseve statistikore, në aspektin metodologjik janë përgatitur të gjitha mostrat e nevojshme si dhe llogaritja e peshave për anketat e realizuara statistikore. Zbatimi i metodës së kalibrimit (calibration) për ri-kalkulimin e peshave Gjithashtu Stafi i metodologjisë ka realizuar një sërë aktivitetesh lidhur me aspektet metodologjike dhe ato të cilësisë në fusha dhe aktivitete të ndryshme statistikore si : Anketa e Fuqisë Punëtore, Anketa mbi Koston e Punës, Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare, SILC, TIK, Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, Anketa e Energjisë, Anketa e Turizmit (përzgjedhja e Qarqeve Regjistruese dhe ekonomive familjare). Në kuadër të statistikave të përgjithshme gjatë vitit 2023 janë publikuar:

Në baza tremujore janë publikuar:

- Buletini Tremujor (TM4/2023, TM1, TM2 dhe TM3/2022),

Në baza vjetore janë publikuar:

- Vjetari Statistikor 2023;
- Kosova në Shifra 2022;
- Katalogu i Publikimeve 2022.

Shpërndarja - Në përputhje me parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP), ASK, paraprakisht publikon në Ueb faqe të saj, Kalendarin Vjetor të publikimeve, duke informuar shfrytëzuesit me kohë për planin e publikimeve si dhe për arsyeshmërinë në rast të vonesave eventuale të publikimit nga data origjinale e saj. Gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi është bërë përkthimi në gjuhet zyrtare i të gjitha publikimeve të dala nga ASK-ë, standardizimi, dhe pajisja me ISBN numër dhe katalog-imi i publikimeve vjetore për të gjitha publikimet e ASK-së. Si pjese e parimeve te CoP të statistikave evropiane, ASK ja ka bere publikimin e kalendarit te publikimeve për vitin 2024, bazuar ne planin e punës të vitit 2023. Të gjitha publikimet dhe dokumentet e ndryshme publikohen ne ueb faqen e ASK-së nga sektori i Shpërndarjes.

Meta data dhe Cilësia

Me mbështetjen e IPA 2017 dhe IPA 2019, është zhvilluar aplikacioni i quajtur SIMS (Single Integrated Metadata Structure) Sistem për Ruajtjen, Menaxhimin dhe Integrimin e Meta datave sipas formatit SIMS 2.0. Përmes këtij sistemi meta datat do të janë të standardizuara dhe të qasshme nga përdoruesit. Ky aplikacion është zhvilluar sipas standardeve të Eurostat-it, ku përmes këtij sistemi baza e njëjtë përdoret për shpërndarjen e meta datave në Ueb faqe të ASK dhe të njëjtat mund të gjenerohen në formatin SDMX për transmetim e të dhënave në Eurostat përmes platformës së tyre Meta data Handler.

Gjatë vitit 2023, ka vazhduar bashkëpunimi profesional ndërinstitucional në mes anëtareve të grupit punues të ASK-ës, Bankës Qendrore (BQ) dhe Ministrisë së Financave, punës dhe transferove (MFPT) për harmonizimin e Mata datave si dhe implementimin e aplikacionit SIMS. Sistemi i Meta datave është në zhvillim e sipër sipas standardeve të Eurostat dhe është duke u bërë popullimi me Raportet e Cilësisë.

Teknologjia Informative dhe GIS

Viti 2023 shënoi një periudhë të përparimeve dhe arritjeve të rëndësishme në fushën e GIS dhe Teknologjisë së Informacionit (TI) në ASK. Me një përkushtim të palëkundur për përmirësimin e cilësisë së të dhënave, kanaleve të komunikimit dhe efikasitetit operativ, ASK zbatoi me sukses një sërë projektesh dhe nismash. Fokusi kryesor ishte në përgatitjen e Regjistrimit të Popullsisë, së bashku me

aktivitete dhe arritje të tjera kyçe në GIS dhe TI.

Janë bërë Investime të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës së TI dhe në zbatimin e GIS brenda kuadrit të statistikave zyrtare. Përmes përmirësimeve të harduerit, softuerit dhe masave të sigurisë, ASK ka përmirësuar aftësitë e saj të përpunimit të të dhënave. Integrimi i të dhënave gjeo-hapësinore dhe përdorimi i veglave të avancuara si GIS mundësoi analizën hapësinore më të mirë dhe vizualizimin e informacionit statistikor. Pavarësisht sfidave, ASK demonstroi përkushtimin e saj për të siguruar statistika zyrtare të sakta dhe të besueshme përmes përmirësimeve të vazhdueshme dhe nismave për ndërtimin e kapaciteteve.

Ueb faqja zyrtare e ASK-së - Me qëllim të modernizimit dhe bërjes sa më të lehte qasjen e shfrytëzuesve në të dhëna zyrtare statistikore, ASK ja gjatë vitit 2023, ka ri dizajnuar ueb faqen e saj duke ofruar një përvojë më të mirë të përdoruesve dhe plotësimin e nevojave të shfrytëzuesve sipas kërkesave të tyre.

Intraneti i ASK - Një sistem i ri intraneti është krijuar për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e brendshëm ndërmjet stafit të ASK-së.

Përmirësimi i SIMS 2.0 - Sistemi i Menaxhimit të Metadatave (SIMS) është përmirësuar në versionin 2.0, duke rritur funksionalitetet dhe efikasitetin e tij.

Përmirësimi i ASKdata - Platforma ASKdata është përmirësuar dhe avancuar me qëllim të të bërit sa më funksional në përdorimin e të dhënave zyrtare përmes moduleve të ndryshme duke bërë të mundur krijimin e tabelave sipas nevojave të përdoruesve për Statistika Zyrtare.

Infrastruktura e Rrjetit dhe Performanca e Sistemit

Infrastruktura e rrjetit është dizajnuar për të siguruar një lidhje të pandërprerë dhe shkëmbim të dhënash midis sistemeve të ndryshme. Ajo mbështet kërkesat në rritje për përpunimin dhe analizën e të dhënave, me masa shkallëzimi të vendosura për të përballuar rritjen e ardhshme dhe kërkesat statistikore në zhvillim. ASK monitoron vazhdimisht performancën e sistemit për të identifikuar ngushticat dhe për të opti mizuar alokimin e burimeve.

Siguria dhe Privatësia e të Dhënave

Politika e Sigurisë dhe privatësia e të dhënave statistikore zyrtare është e një rëndësie të veçantë për ASK-në dhe qytetarët e republikës së Kosovës. Infrastruktura e TI përfshin masa të forta sigurie, përfshirë firewall-e, mekanizma enkriptimi dhe kontrolle qasje, për të mbrojtur informacionet e ndjeshme. Kontrollet e rregullta të sigurisë dhe vlerësimet e dobësive kryhen për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë pro aktive rreziqet e mundshme.

Ruajtja dhe Backup-i i të Dhënave

Për shkak të volumit të madh të të dhënave në Statistikat Zyrtare, një sistem efikas dhe i besueshëm për ruajtjen dhe backup-in e të dhënave është thelbësor. ASK ka zbatuar një zgjidhje të centralizuar për ruajtjen e të dhënave dhe kryen backup-e të rregullta për të siguruar konsistencën e të dhënave dhe aftësitë e rikuperimit në rast fatkeqësish.

Përmirësimi i Mbledhjes dhe Analizës së të Dhënave Gjeo-hapësinore

ASK-ja dhe stafi i saj, kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave gjeo-hapësinore përmes veglave të ndryshme, duke përfshirë imazhet satelitore, anketat dhe bashkëpunimin me agjenci të tjera të institucioneve të Kosovës. Kjo, bëri që informacioni gjeografik të

jetë më i saktë dhe i përditësuar dhe të përfshihet në analizat statistikore. ASK u fokusua në zhvillimin e veglave dhe teknikave të avancuara për analizën dhe vizualizimin hapësinor të të dhënave statistikore. Softueri GIS u përdor për të krijuar harta interaktive, grafikë dhe diagrame, duke lehtësuar kuptimin dhe interpretimin më të mirë të modeleve dhe trendëve gjeografike.

Modernizimi i Mbledhjes së të Dhënave

ASK ka dixhitalizuar mbledhjen e të dhënave duke përdorur teknologji të avancuara për të mbledhur të dhëna me metoda moderne si CAPI, CAWI dhe CATI. Këto metoda kanë luajtur një rol të rëndësishëm në modernizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave në ASK. Kjo qasje e thjeshtësoi procesin e mbledhjes së të dhënave, rriti efikasitetin dhe minimizoi gabimet njerëzore, cost efektivitetin në kohë dhe kosto për mbledhjen e të dhënave. Si rezultat i qasjes me metodat e reja, janë eliminuar disa procese si futja e te dhënave ne sistemin e bazës së shënimeve përmes operatoreve individual.

Metoda CATI (intervista telefonike me ndihmën e kompjuterit) ka luajtur një rol të rëndësishëm në modernizimin e mbledhjes së të dhënave duke mundësuar intervista në distancë. Zyrtarët e ASK-së zhvillojnë intervista përmes telefonit, duke eliminuar nevojën për ndërveprime ballë për ballë. Ky qasje ofroi lehtësi për të dy palët, si për respoendntët ashtu edhe për intervistuesit.

Metoda CAWI (Intervistë në internet me ndihmën e kompjuterit) lehtësoi mbledhjen e të dhënave në një shkallë të gjerë duke shfrytëzuar fuqinë e internetit. Zyrtarët e ASK-së shpërndanë pyetësorë online, duke lejuar përgjegjësit të plotësojnë anketat online. Kjo metodë përfshin masa sigurie për të dhënat dhe kontrolle të vlefshmërisë për të siguruar integritetin dhe saktësinë e përgjigjeve. Protokollet e enkriptimit dhe fushat e detyrueshme të përgjigjeve minimizuan gabimet në futjen e të dhënave, duke rritur besueshmërinë e informacionit të mbledhur.

Duke aplikuar këto metoda, u bë e mundur validimi i të dhënave në kohë reale. Aplikacionet e zhvilluara nga ASK mundësuan kontrolle të menjëhershme për përgjigjet që mungojnë ose të dhëna jo konsistente, duke lejuar sqarimin e menjëhershëm të përgjigjeve gjatë procesit të intervistës dhe duke siguruar cilësi të lartë të të dhënave. Falë këtyre teknologjive, më shumë se 35 projekte janë finalizuar me sukses, duke rritur kapacitetet dhe efikasitetin e ASK-së.

ASK është fokusuar në gjetjen e mënyrave për të lehtësuar barrën e përgjigjeve, duke përdorur metoda që janë më të shpejta dhe më pak të lodhshme për respondentet. Nga ajo që u tha më lartë sistemi duket si në figurën e mëposhtme.

Fig. 2. Metodat e mbledhjes së të dhënave në ASK



Më poshtë janë paraqitur ndër vite aplikimi i metodave të reja në mbledhjen e të dhënave sipas aktiviteteve të ndryshme statistikore.

Table 1. Anketat e zhvilluara me metodën CAPI-CAWI 2019-2023

Përshkrimi i aktivitetit	2019	2020	2021	2022	2023
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për kuartet e banimit kolektiv (formulari C1)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni i ekonomive familjare institucionale-kolektive (formulari C2)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për banesë (formulari R1)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni i ekonomisë familjare (formulari R2)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni individual (formulari R3)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi Popullsisë - aplikacioni për anëtarët e ekonomisë familjare të cilët jetojnë jashtë Kosovës (formulari S1)	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Regjistrimi popullsisë - aplikacioni për anëtarët pas regjistrim	*NA*	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Azhurnimi Qarqeve Regjistruese	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa për Kostot e Punës	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Fuqisë Punëtore	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI-CATI*	*CAPI-CATI*
Anketa Dhuna në baza gjinore	*NA*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
SILC	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	
Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)	*CAPI*				
PILOTI-Regjistrimi		*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Ekonomive Bujqësore		*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Pemëtarisë	*CAPI*				
Anketa e Hotelerisë	*CAËI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Statistikave të Energjisë në Ekonomi Familjare dhe Biznese	*PAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Azhurnimi i RSB	*CAËI-CAPI*	*CAËI-CAPI*	*CAËI-CAPI*	*CAWI-CAPI*	*CAWI-CAPI*
Anketa e Investimeve	*PAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Anketa e Teknologjisë Informative në Biznese	*PAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
PRODCOM	*PAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
ASN - Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve	*PAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*	*CAPI*
Statistikat e Arsimit të Lartë				*CAWI*	*CAPI*
Statistikat e Arsimit të të Rriturve				*CAPI*	*CAPI*
Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi					*CAPI*
Aksidentet në punë dhe probleme të tjera shëndetësore të shkaktuara në vendet e punës					*CAPI*
Anketa e mbeturinave industriale					*CAPI*

REGJISTRIMI I POPULLSISE (Zhvillimi i testit te regjistrimit te popullsisë)

Në kuadër të përgatitjeve për Regjistrimin e Popullsisë, janë kryer një sërë veprimesh teknike dhe logjistike për të siguruar një proces të suksesshëm dhe efikas.

Aktivitet e zhvilluara me proces prokurimi

Për qëllimet e regjistrimit, janë prokuruar 3000 tableta dhe 800 laptop. Në këtë rrafsh procesi i instalimit dhe konfigurimit të tabletave dhe laptopve është kryer për të siguruar që pajisjet të janë gati për përdorim gjatë regjistrimit, nga regjistruesit dhe mbikëqyrësit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

Është zhvilluar një aplikacion i dedikuar për përzgjedhjen dhe menaxhimin e aplikimeve të Regjistruesve dhe Mbikëqyrësve për Regjistrim të Popullsisë.

Aplikacioni (FORMULARI S1) Ky aplikacion është zhvilluar në teknologjinë. NET, i destinuar në mbledhjen e të dhënave për anëtarët e familjeve që jetojnë jashtë Kosovës.

Janë përgatitur server virtual në përputhje me standardet ASHI dhe është krijuar një sistem për balancimin e ngarkesës për të siguruar performancë optimale të sistemit si dhe janë marrë masa të forta sigurie për të mbrojtur të dhënat dhe sistemet nga kërcënimet e mundshme.

Përgatitja e Materialeve dhe Trajnimeve

Janë përgatitur materiale të detajuara trajnimi dhe udhëzues për Regjistruesit dhe Mbikëqyrësit. Këto materiale përfshijnë udhëzime praktike dhe plane trajnimi për të siguruar që personeli është i përgatitur për detyrat e tyre.

Përmirësimet në GIS dhe Zhvillimi i WebGIS

Janë prokuruar licenca për GIS dhe ka nisur zhvillimi i WebGIS për të përmirësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave gjeo-hapësinore. Është krijuar infrastruktura e nevojshme për të postuar aplikacionin WebGIS. Gjithashtu është bërë finalizimi i Aplikacionit pas Shtimit të Pyetjeve të Reja dhe Përkthimit në 3 Gjuhë të tjera: Aplikacioni për Regjistrimin e Popullsisë është finalizuar pas shtimit të pyetjeve të reja dhe përkthimit të tij në tre gjuhë të tjera.

Si pjesë e materialeve trajnuese është bërë edhe përgatitja e Detyrave për 3500 Regjistrues: Janë përgatitur detyrat dhe udhëzimet për 3500 Regjistrues. Janë përgatitur harta dixhitale për 5000 Zona Regjistruese, të cilat janë të integruara me pajisjet e regjistruesve dhe të lidhura me kodet QR. Gjithashtu janë përgatitur dhe printuar 5000 harta të bazuara në kodet QR për përdorim gjatë Regjistrimit.

Uebfaqja e Regjistrimit është krijuar një uebfaqe e dedikuar për Regjistrimin e Popullsisë. Përgatitja e ToR për Zhvillimin e Modulit/Dashboard për Monitorimin e procesit të Regjistrimit. Krijimi i Raporteve Ditore dhe më Shpesh gjatë Procesit të Regjistrimit, janë krijuar raporte ditore dhe më të shpeshta për të monitoruar progresin e Regjistrimit. Sigurimi i Mbështetjes në Terren sipas Komunave: Është siguruar mbështetje në terren për çdo komunë për të adresuar sfidat dhe problemet që mund të lindin.

Dërgimi dhe shkëmbimi i të dhënave me institucionet ndërkombëtare

Në vitin 2023, ASK ka zhvilluar me sukses aktivitete të transmetimit dhe shkëmbimit të të dhënave me organizatat ndërkombëtare, përfshirë EUROSTAT-in. Kanalet e sigurta të komunikimit, dorëzimet në kohë të të dhënave dhe përpjekjet për harmonizimin e të dhënave ishin arritjet kryesore. Sfidat në lidhje me harmonizimin e të dhënave dhe përputhshmërinë teknike u adresuan përmes përmirësimeve të vazhdueshme. Zbatimi i vlefshmërisë së fortë të të dhënave, sigurimit të cilësisë dhe masave të sigurisë siguruan integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave të shkëmbyera. ASK mbetet e përkushtuar në

forcimin e aftësive të saj të shkëmbimit të të dhënave dhe nxitjen e bashkëpunimeve me organizatat ndërkombëtare për raportim dhe analizë të zgjeruar statistikore.

Kanalet dhe platformat e aplikuara

Edamis/EUROSTAT

Sistemi eDAMIS, është një platformë unike e zhvilluar nga Eurostat, të cilën e aplikojnë të gjitha vendet për transmetimin e të dhënave të caktuara në Eurostat. Në ktë rrafsh ky sistem ka luajtur një rol vendimtar në lehtësimin e transmetimit efikas dhe të saktë të të dhënave nga ASK-ja në Eurostat. Duke ofruar funksione për mbledhjen e të dhënave, vërtetimin, kontrollin e cilësisë, menaxhimin e metadatave dhe transferimin e sigurt të të dhënave, eDAMIS ka thjeshtuar të gjithë procesin e transmetimit të të dhënave. Kjo ka rezultuar në paraqitjen në kohë dhe të besueshme të të dhënave në Eurostat, duke siguruar përputhjen me standardet e raportimit. Masat e fuqishme të sigurisë të sistemit kanë ruajtur gjithashtu konfidencialitetin e të dhënave të transmetuara. Në përgjithësi, eDAMIS ka përmirësuar ndjeshëm qeverisjen e të dhënave dhe ka kontribuar në bashkëpunimin e suksesshëm ndërmjet ASK-së dhe Eurostat-it në fushën e Statistikave Zyrtare.

DSBB (Bordi i Buletinit të Standardeve të Shpërndarjes), FMN

Në bashkëpunim me MeF dhe BQK-në, është zbatuar Sistemi i Avancuar i Shpërndarjes së të dhënave të përgjithshme të FMN-së. ASK-ja, në baza mujore dhe tremujore i dërgon të dhënat në FMN, në formatin SDMX, për disa fusha statistikore.

SDMX (Shkëmbimi i të Dhënave dhe Meta datave Statistikore)

Implementimi i SDMX në ASK për shkëmbimin e të dhënave me organizatat ndërkombëtare ka sjellë përfitime të shumta. Formati i standardizuar ka përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e të dhënave, ka promovuar ndërveprimin dhe ka lehtësuar analizën dhe krahasimin e të dhënave. SDMX ka luajtur një rol jetik në thjeshtimin e proceseve të shkëmbimit të të dhënave, duke siguruar qëndrueshmërinë dhe përputhshmërinë e të dhënave statistikore dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet organizatave. ASK mbetet e përkushtuar në shfrytëzimin e SDMX për shkëmbim efektiv të të dhënave, duke kontribuar në avancimin e raportimit dhe analizës statistikore ndërkombëtare.

ASKData-platforma për shpërndarjen e të dhënave statistikore

ASKData ka luajtur një rol kryesor në procesin e shpërndarjes së të dhënave në ASK. Ndërfaqja e tij miqësore për përdoruesit, vizualizimi fleksibël i të dhënave, përzgjedhja interaktive e të dhënave dhe përditësimet dinamike kanë përmirësuar ndjeshëm qasjen, efikasitetin dhe përdorsh-mërinë e të dhënave statistikore. Përdorimi i ASKData i ka fuqizuar përdoruesit të eksplorojnë, analizojnë dhe interpretojnë të dhënat në mënyrë më efektive, duke lehtësuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe duke u mundësuar palëve të interesuara të përdorin informacion të saktë dhe në kohë për nevojat e tyre përkatëse. ASK mbetet e përkushtuar në shfrytëzimin e ASKData dhe avancimeve të tjera teknologjike për të përmirësuar më tej procesin e shpërndarjes së të dhënave dhe për të siguruar disponueshmërinë e Statistikave Zyrtare me cilësi të lartë për përdoruesit. Numri i tabelave të integruara në ASKdata deri më tani është mbi 1500.

ESDS (Qendrën për Mbështetje për Statistika Evropiane)

Që nga viti 2016, ASK-ja si pjesë e sistemit të ESDS-it, përveç që dërgon të dhëna në Eurostat, gjithashtu promovon dhe ofron mbështetje për të gjithë përdoruesit që janë të interesuar për të dhënat e ASK-së por edhe me gjerë. Përmes këtij sistemi, ASK-ja ndihmon përdoruesit e saj në verifikimin e të dhënave, u sigurohen informacione shtesë mbi metodologjinë dhe ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve teknike, duke ofruar përgjigje në gjuhën shqipe. ESDS në gjuhën shqipe menaxhohet nga ASK-ja, në bashkëpunim të

ngushtë me Eurostat-in.

SIPK (Sistemi i Përdorimit te Kohës)

Për shkak të projektit të Regjistrimit të Popullsisë i cili ishte me projekt me prioritet të lartë për ASK-në dhe Institucionet e Kosovës, për vitin 2023 nuk ishte e mundur të mirëmbahet sistemi i SIPK-ut gjegjësisht të bëhet furnizimi i sistemit me të dhënat për vitin 2023. Në planifikim dhe monitorim sipas indikatorëve përmes të cilëve matet performanca në nivel individual (të punësuar) dhe Institucional (ASK-së). Megjithatë ASK, ka bërë përpjekje për të matur performancën në ata indikatorë ku ishte e mundur në mënyrë manuale për të krahasuar rezultatet e vitit 2023 me një vit ma pare gjegjësisht vitin 2022 në veçanti tek indikatorët; 1, 1a, 6 dhe 7. Megjithëkëtë sapo të jetë e mundur do të bëhet mirëmbajtja harduerike dhe softuerike, konfigurimi i sistemit, niveli i qasjes së përdoruesve si dhe mënyra e veprimit në rast të pasigurisë janë disa nga aktivitetet që ka zhvilluar stafi i TI-së për funksionim normal të sistemit të SIPK-ut.

Siç është shpjeguar edhe më lartë sistemi i SIPK-ut, shërben për t'ju mundësuar përdoruesve në ASK shpërndarjen e orëve duke u bazuar në aktivitetet statistikore në baza ditore, ku pastaj bënë konvertimin e orëve në ditë pune për ti krahasuar me ditët e planifikuara në periudha mujore, tremujore dhe vjetore.

1.10. Personeli dhe ngritja e kapaciteteve në ASK

Edhe përkundër aktiviteteve të shumta gjatë vitit 2023 e ndër më kryesoret, përgatitjet për Regjistrimin e Popullsisë në Kosovë, ASK ja është ballafaquar me kufizime në numër të resurseve njerëzore, si rezultat i pozitave të lëna bosh nga procesi i pensionimit të Stafit. Nevojat e ASK-së, për staf shtesë (përveç plotësimit të pozitave aktuale), janë të mëdha me qëllim të shtrirjes se aktiviteteve të reja si në aspektin prodhues po ashtu edhe në konsolidimin e njësive të reja si SDGs, planifikim dhe monitorim të projekteve statistikore. Për këtë qëllim me rastin e përgatitjes së Draft rregullores për riorganizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, ASK, ka kërkuar numër shtese të stafit me qëllim të rritjes se efikasitetit teknik dhe profesional te saj.

Resurset njerëzore

- 166 pozita te aprovuara
- 223 pozita të nevojshme
- 25 pozita te lira
- 141 aktiv gjate vitit 2023

Në anën tjetër ka vazhduar ngritja e kapaciteteve teknike profesionale e stafit të ASK-së përmes trajnimeve dhe formave tjera aktiviteteve si pjesëmarrja në konferenca të ndryshme, grupe punuese, vizita studimore e mënyra tjera të ngritjes së kapacitetеve të stafit profesional në ASK.

Përveç përparësive në mundësinë e ofruar nga partnerët tanë në trajnime të ndryshme, Viti 2023, është karakterizuar me pengesa dhe vështirësi për shkak të pamundësisë për plotësimin e pozitave të lira nga ndryshimet e fundit në kornizën ligjore gjegjësisht në

ligjin për Zyrtarët publik. ASK, në mungesë të stafit ka bërë përpjekje maksimale që mirëmbajtja e aktiviteteve të mos nder prehet duke shfrytëzuar burimet alternative duke bërë delegimin e detyrave tek stafi tjetër gjatë ditëve të vikendit apo me orar të zgjeruar të punës me qëllim të realizmit të planit të punës. Gjatë vitit 2023, ASK ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë për punësim me qëllim të rekrutimit të stafit me kontrata të veçanta per një periudhë 6 mujore me mundësi vazhdimi sipas legjislacionit në fuqi.
Me buxhetin për vitin 2023, të aprovuara në total kanë qenë (buxheti i siguruar respektivisht aprovuar) 166 pozita në ASK, ndërsa deri në fund të vitit 2023, të punësuar kanë qenë 141 punëtor pra 25 pozita të pambuluara për arsyet e lartcekura.

Në Kosovë, trajnime në fushën e statistikave ende nuk ka të siguruar megjithatë fatmirësisht me përkrahjen e partnerëve tanë, ngritja e kapaciteteve të stafit të ASK-së, ka vazhduar me mbështetjen e fondeve të IPA 2019, si dhe partnereve tjerë si SIDA, UNICEF, UNFP, FMN, etj. në sektorë të ndryshëm. Stafi ASK, ka qene pjese e trajnimeve dhe aktiviteteve të shumta me përkrahje të Eurostat respektivisht IPA programit, në të gjitha aktivitetet e parapara horizontale si trajnimet, seminaret, grupet punuese, vizitat studimore, konferencat, etj.

1.11. Pasqyrat e Performancës së ASK-së

Efektiviteti dhe efikasiteti janë ndër parimet bazë në Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP). Andaj, ASK është duke i kushtuar rëndësi gjithnjë e më shumë edhe anës cilësore të prodhimit statistikor, respektivisht matjes së progresit, brenda vetë procesit të prodhimit statistikor. Përveç fazës së planifikimit e cila determinon orientimin në rezultate po ashtu edhe faza e monitorimit konsiderohet proces mjaft i rëndësishëm në kuadër të sistemit menaxhues, lidhur me proceset statistikore në ASK. Regjistrimi i Popullsisë ka ndikuar në sistemin e SIPK-ut, ashtu që gjatë vitit 2023, nuk ka mundur të bëhet mirëmbajtja e sistemit me inpute për shkaqe të cekura më lartë. Andaj matja e përformancës në nivel zyrtari, produkti, departamenti dhe në nivel të ASK-së, nuk është bërë për të gjithë indikatorët me përjashtim të indikatorit 1, 1a, 6 dhe 7 në mënyrë manuale. Performanca matet duke krahasuar gjendjen aktuale me atë të vitit paraprak për numrin e produkteve dhe publikimeve statistikore, kohës prodhuese, numrin e ditëve për produkt, normën e publikimeve në kohë, etj. Rezultatet e prezantuara administrohen përmes Kornizës Vlerësuese të Performancës (KVP-së), në kuadër të së cilës ekzistojnë indikatorët, sistemimi i të cilëve bëhet përmes Sistemit Elektronik për Matjen e Kohës (SIPK-ut) dhe njësive tjera horizontale.

Produkte/raporte statistikore - Gjatë vitit 2023, në programin e ASK-së, kanë qenë të aktivizuara (ose punë të shpërndara) gjithsej 82 produkte statistikore, krahasuar me vitin 2022, që ishin 76 sosh. Ndërsa numri i publikimeve statistikore gjatë vitit 2023 është regjistruar të jetë 213 sosh, krahasuar me vitin 2022 të cilat ishin 172 raporte statistikore.

Përveç progresit ka pasur edhe sfida në veçanti në fushën e statistikave sociale, disa publikime gjegjësisht publikimi i të dhënave nga Anketa e Fuqisë Punëtore ka pasur vonesa në mbledhjen e si pasoje edhe ne publikimin e tyre. Statistikat e kulturës dhe sportit nuk janë publikuar fare si rezultat i mungesës në sigurimin e të dhënave nga institucioni gjegjes po ashtu edhe të dhënat për statistikat e jurispodencës gjegjësisht për personat e mitur dhe të moshën madhore nuk janë publikuar si rezultat i mungesë së të dhënave nga KGJK. Rritja e numrit të publikimeve është si rezultat i kalimit të publikimeve nga ato tremujore në baza mujore, qëllim i vazhdueshëm i ASK-së për të ofruar të dhënat te shfrytëzuesi në kohë optimale.

Numri i ditëve për produkt – Sipas të dhënave të SIPK-ut, krahasues mëria në vitin 2022 në raport me vitin 2023 bëhet me 54 produkte statistikore. Në nivel të ASK-së, për të njëjtat produkte (54 te krahasueshme) në vitin 2022 janë shpenzuar gjithsej 5303 dite-pune krahasuar me vitin 2023, që ishin 5284 dite pune. Siç është cekur më lartë, ASK, bën matjen e përformancës (efikasitet veprues-prodhues) edhe në nivel të produktit statistikor. Në vitin 2022 në krahasim me vitin 2023, numri i ditëve për produktet e

krahasueshme ka regjistruar një rritje të lehte prej 19 ditë si rezultat faktorëve të cekur më sipër. (shtrirjes se numrit të ri të produkteve dhe mungesës së stafit nga pensionimi).

Pasqyrat e Performancës SIPK 2023

- Produkte Statistikore 82, (6 me shume apo 7.9% produkte se Tn-1);
- Publikime statistikore 213 apo 41 publikime më shume se në vitin 2022, rritje (23.8%);
- Ditë pune mesatarisht 98/produkt të krahasueshme me një viti më parë;
- Ditë pune mesatarisht 78/produkt për të gjitha produktet (76);
- Koha prodhuese (afatet kohore), për produktet krahasuese (54) ishte 10214 dite kalendarike apo mesatarisht 189/produkt, në vitin 2023 ishte 232 ditë kalendarike (-18.5%);
- Publikime në Kohë 95%, apo 203 prej 213 publikimeve janë publikuar në kohen e paraparë;
- Norma e përfshirjes (në publikimet e Eurostat per Enlargement countries) 65.8% apo nga 190 me 125 tregues e përfshirë

Koha Prodhuese – Paraqet kohën e publikimit statistikor nga data e fundit, referuar kohës së hulumtimit deri te dita e publikimit. Gjatë vitit 2022, koha prodhuese, ka shënuar një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak 2023 respektivisht nga 12537 ditë kalendarikë që ishte në vitin 2023 në 10214 ditë kalendarike në vitin 2022 për 54 produktet e krahasueshme. Pra afati kohor nga dita e fundit e hulumtimit statistikor deri tek data e publikimit të raportit në nivel të të gjitha publikimeve statistikore është 15221 ditë kalendarike apo mesatarisht 86.5 ditë kalendarike për raport statistikor krahasuar me vitin paraprak ishte 101.5 ditë kalendarike.

Me fjalë të tjera gjatë vitit 2023, situata është më mirë krahasuar me një vit më parë në nivel të të gjitha publikimeve. Pra ka rënie të kohës prodhuese shprehur ne terma mesatar aritmetik, nga 226 ditë kalendarikë në 200 ditë kalendarike gjatë vitit 2023, pra është shënuar rënie ndër vite e që është edhe qëllimi i ASK-së. (me shpejte per 26 dite per publikim statistikor).

Norma e publikimeve në kohë – Sipas parimeve të Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane (CoP), dhe Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, kalendari i publikimeve duhet të publikohet 3 muaj para vitit pasues. Andaj saktësia e publikimit në kohë të Statistikave Zyrtare është jashtëzakonisht e rëndësishme për shfrytëzuesit e statistikave në aspektin e të bërit politika dhe pritjeve për statistika zyrtare. Gjatë vitit raportues nga gjithsej 213 publikime të realizuara (publikuara) 203 prej tyre janë publikuar në kohën e saktë apo 95% e tyre (3% me shume se nj viti më parë). Ndërsa disa prej tyre janë publikuar me vonesa siç kemi cekur me lartë tek të dhënat e tregut të punës.

Pasqyrë më të qartë lidhur me zhvillimin e cilësisë pritet të ketë në periudhën e ardhshme, sidomos për indikatorët 7 dhe 8. Në tabelat e mëposhtme janë dhënë pasqyrat e përformancës në nivel të ASK-së dhe në nivel të Departamenteve, sipas treguesve të nxjerrë nga Sistemi Informativ për Përdorimin e Kohës (SIPK).

Tabelat: Pasqyra e Performancës në nivel të ASK-së (SIPK)

Treguesi 1. Numri i produkteve dhe raporteve Statistikore 2023/2022

Statistikat sektoriale	Produktet statistikore		Publikime statistikore		+-(%) publikime
	2022	2023	2022	2023	2023/2022
Bujqësisë dhe Mjedisit	11	11	16	17	6.25%
Llogarive kombëtare dhe ekonomike	35	40	110	131	19%
Sociale dhe të Popullsisë	23	24	38	58	52.6%
Të përgjithshme	7	7	8	7	-12.5%
Gjithsej	76	82	172	213	23.8%

Treguesi 4. Ditë pune – planifikuar dhe realizuar brenda proceseve prodhuese fazat 1-7[1]

Statistikat sektoriale	Ditë pune të planifikuara	Ditë pune të realizuara	Ndryshimi
Bujqësisë dhe Mjedisit	1395	1446	4%
Llogarive kombëtare dhe ekonomike	1992	2328	17%
Sociale dhe të Popullsisë	2425	2039	-16%
Të përgjithshme	198	124	-38%
Gjithsej	6010	5937	-1.2%

Treguesi 4a. Ditë pune - brenda dhe jashtë procesit prodhues (fazat 1-7 dhe 8-11)

Statistikat sektoriale	Gjithsej dite pune	Brenda procesit prodhues	Jashtë procesit prodhues	Proporcioni i jashtëm (%)
Bujqësisë dhe Mjedisit	1540	1446	80	1%
Llogarive kombëtare dhe ekonomike	2429	2328	64	2%
Sociale dhe të Popullsisë	2398	2039	340	1%
Te përgjithshme	192	124	68	0%
Gjithsej	6560	5937	552	1%

Bazuar në modelin statistikor GSPBM, model përmes të cilit janë të përshkruara të gjitha fazat statistikore në procesin e prodhimit statistikor (nga identifikimi i nevojave deri te procesi i arkivimit pas fazës së shpërndarjes) gjatë vitit 202~~2~~3, gjithsej në nivel të ASK-së, janë harxhuar 6560 ditë pune. Ndërsa vetëm në proceset prodhuese fazat nga 1-7) janë materializuar ne procesin prodhues 5937 ditë pune apo 91 % e kohës totale, pjesa tjetër prej 9% janë kohë e harxhuar në fazat tjera 8-11 si trajnime, takime, me punë me palët, etj.

[1] *Fazat 1-7, Paraqesin fazat e procesit të prodhimit statistikor sipas GSPBM. 1- Identifikimi i nevojave; 7 Disiminimi apo publikimi i Raportit Statistikor*

Treguesi 5. Koha prodhuese për produktet e krahasueshme 2023/22 / viti 2022=76/54

produkte të krahasueshme

Statistikat sektoriale	Koha Prodhuese 2022	Koha Prodhuese 2023	Ndryshimi	Proporcioni i jashtëm (%)
Bujqësisë dhe Mjedisit	1726	1721	-5	-0.3%
Llogarive kombëtare dhe ekonomike	5920	4244	-1676	-28.3%
Sociale dhe të Popullsisë	3888	3616	-272	-7.0%
Te përgjithshme	1003	633	-370	-36.8%
Gjithsej	12537	10214	-2323	-18.5%

Siç mund të shihet nga të dhënat e prezantuara në tabelë, koha prodhuese për produktet e krahasueshme e vitin 2022, është më e shkurtë krahasuar me një vit më parë. Respektivisht ASK, ka shfaqur performancë më të mirë në ofrimin e produkteve statistikore tek përdoruesit në një kohë më të shkurtër në shifra absolute për 2323 ditë apo mesatarisht për produkt statistikor rreth 43 dite me shpejte. Nga të dhënat e regjistruara përmes sistemit të SIPK-ut, viti 2023 në nivel të ASK-së, ka shënuar rënie për -2323 ditë kalendarike, apo mesatarisht -43 ditë në publikimin e të dhënave statistikore, më herët në krahasim me vitin paraprak.(-2323/54).

Treguesi 6. Shkalla e publikimeve në kohë 2023 krahasuar me vitin 2022

Statistikat sektoriale	Publikimet 2023		Në kohë	Krahasimi në %	
	Planifikuara	Realizuara	2023	2022	2023
Bujqësisë dhe Mjedisit	18	17	16	94%	94%
Llogarive kombëtare dhe ekonomike	126	131	130	97%	99%
Sociale dhe të Popullsisë	54	58	50	76%	86%
Te përgjithshme	8	7	7	100%	100%
Gjithsej	206	213	203	92%	95%

Nga të dhënat e mësipërme shihet se shkalla e publikimeve në kohë në vitin 2023 ne nivel te ASK-se, ishte 95%, per 3 shkalle të përqindjes më shumë se në vitin 2022. Sipas fushave sektoriale, përqindja e numrit të publikimeve në kohen e paraparë varion nga 86% me e ulëta te statistikat sociale dhe te popullsisë dhe me e larta te publikimet e përgjithshme 100% te pasura nga statistikat e llogarive kombëtare dhe ekonomike me 99% dhe ato te bujqësisë dhe mjedisit me 94% e publikimeve në kohë. Statistikat sociale respektivisht statistikat e tregut të punës janë publikuar me vonesë për shkak të mbledhjes së të dhënave nga tereni me vonesë.

Përfomanca përmbledhëse në nivel të ASK-së

Treguesit	**Gjendja 2022**	**Në vitin 2022 janë 54 produkte krahasuese**		**Ndryshimi**
përshkrimi	**1**	**Viti 2023**	**Viti 2022**	**%**
T1.Produkte statistikore	76	82	76	7.9%
T1a.Publikime Statistikore	172	213	172	23.8%
T4.Dite pune për produkt (gjithsej)	5937	5284	5303	-0.3%
T4a.Dite pune për produkt (mesatare)	78	97.8	98.2	-0.4%
T5. Koha prodhuese (gjithsej)	15221	10214	12537	-18.5%
T5a. Koha Prodhuese (mesatarisht)	200	189	232	-18.5%
T6. Norma e publikimeve në	92	203/213	159/172	44/41
N**ë nivel të ASK-së, në %**		**95**	**92**	

Siç, është shpjeguar edhe më parë, numri i produkteve të aktivizuara në programin e ASK-së, vari-jon sipas programit 5 vjeçar të Statistikave Zyrtare dhe standardeve të caktuara kohore në hulumtimin e një dukurie statistikore. Thënë me fjalë të tjera edhe pse disa nga publikimet statistikore nuk publikohen gjatë vitit përkatës (raportues) ato mbesin të aktivizuara si produkte dhe si rezultat materializohen dite pune (shpenzohet dite pune) për shkak të asaj se frekuenca e publikimit të tyre është më shumë se një vit (2 vjet apo 5 vite). Madje në projektet e mëdha si Regjistrimi i Popullsisë dhe ai Bujqësisë deri në 10 vite. Nga të dhënat e mësipërme mund të konkludojmë se efikasiteti organizativ prodhues në disa tregues ka shënuar rritje si bie fjala (treguesi 1, 1a, 4 dhe 5).

2. ANALIZA E PRIORITETEVE

2.1 Konsolidimi i Kornizës Ligjore

Konsolidimi i një kuadri ligjor i referohet procesit të kombinimit të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave të ndryshme ligjore në një trup ligjor koherent dhe të unifikuar. Andaj per te ndihmuar dhe thjeshtëzuar proceset operative ishte e nevojshme edhe hartimi i disa proceseve ligjore, me qellim të qartësisë në aspektin procedural dhe rritjen e qartësisë dhe qasjes për individët, bizneset dhe te tjerët. Në këtë aspekt ASK, ja bazuar në Ligjin Nr. 04/l-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe Ligjin Nr. 06/L-058 për ndryshim-plotësimin e, gjatë periudhës raportuese ka hartuar dhe ka dërguar në Qeveri dy Draft Udhëzimeve Administrative:

a. Udhëzimi Administrativ mbi Konfidencialitetin e të Dhënave Statistikore si dhe
b. Udhëzimi Administrativ mbi Shitjen e të dhënave Statistikore.

Të dy Udhëzimet Administrative janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe janë në zbatim në përputhje me qëllimin e tyre. Qëllimi i këtyre UA, është thjeshtimi, për të reduktuar kompleksitetin dhe qartësuar procedurat për veprim në rrethana kur kërkohet. Këto UA, përqendrohen në fusha specifike të ligjit, të lartpërmendur .

Korniza Ligjore, përfshirë pothuajse shumicën e kërkesave të ASK-së dhe rekomandimeve të Eurostatit, për fuqizimin e ASK-së dhe pavarësisë profesionale dhe institucionale të ASK-së në kuadër të Sistemit Statistikor të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, në kuadër të këtyre plotësimeve ligjore, janë përfshirë edhe të gjitha Parimet e Kodit të Praktikës Evropiane për Statistika.

2.2 Regjistrimi i Popullsisë 2023/24

Viti 2023, ishte viti i angazhimeve të shumta dhe gjithëpërfshirëse në aspektin e trajtimit të Regjistrimit si prioritet për ASK, Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe shumë institucione tjera të Kosovës. Gjatë procesit kishte sfida sidomos në sigurimin me kohë të pajisjeve. Në pamundësi për të siguruar tablete, me kohe dhe cilësi, Qeveria e Kosovës me propozim të ASK-së kishte marrë vendim për shtyrjen e regjistrimit të popullsisë për vitin 2024, për arsye të cekura më lartë. Megjithatë gjatë vitit 2023, janë zhvilluar aktivitete të shumta (të cilat i kemi trajtuar më në detaje tek pjesa e zhvillimeve tek statistikat sektoriale) përfshirë testet e ndryshme për funksionimin e terë procesit nga materiali statistikor, pajisjet si dhe puna ne teren gjegjësisht orientimi në teren sipas qarqeve dhe brenda qarqeve regjistruese. Po ashtu, koordinimi me institucionet ndërkombëtare ishte i nevojshëm dhe në nivel kombëtar.

2.3 Zhvillimi i kapaciteteve të tjera

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve teknike- profesionale ka vazhduar edhe gjate vitit 2023, fale përkrahjes nga Eurostat dhe partnerët tjerë. Në anën tjetër në aspektin e brendshëm, vetëm tek në fund të vitit 2023, i është lejuar ASK-së, mundësia e hapjes se rekrutimeve të reja për plotësimin e pozitave të reja dhe zëvendësimin e atyre të cilat kanë kaluar të lira si pasoje e pensionimit të stafit.

Fuqizimi i Planifikimit dhe Korniza e vlerësimit të përformancës

Siç e kemi shpjeguar me herët gjatë vitit 2023, ka pasur sfida në këtë drejtim për shkak të absorbimit dhe përqendrimit të stafit te TI në projektin e regjistrimit të popullsisë. Andaj gjate vitit 2023, sistemi i SIPK-ut nuk është mirëmbajtur, megjithatë "vegla" e Kornizës Vlerësuese të Performancës, përveç nga të dhënat e Sistemit të SIPK-ut si, ka edhe indikatorë që sigurohen nga njësi dhe burime tjera. Kjo ka bërë të mundur realizimin e asaj ku ishte e mundur të bëhet matja e performancës. Qasja shumëdimensionale në procesin e planifikimit përfshinë Planet Vjetore të Punës, Hartën Rrugore, Raportet Vjetore, Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA në fushën e Statistikave, si dhe realizimi me sukses i zbatimit i rekomandimeve për vitin 2023, që dalin nga procesi i Vlerësimit ndërkombëtar "Peer Review 2017". Vlerësimi i përformancës do të konsiderohet prioritet edhe gjatë viteve të ardhshme. Rundi ardhshëm Peer Review do të zhvillohet në vendet në zgjerim në intervalin kohor 2025-2027, ASK, ka propozuar qe ekipi eksperteve te vizitojnë vendin ne Korrik 2025.

Nga të dhënat e SIPK-ut janë marruar informacione të rëndësishme, përmes të cilave është bërë identifikimi i masave të nevojshme, me qëllim të ri alokimit të resurseve në kuadër të njësive përkatëse, përmirësim të vetë procesit të planifikimit. Raportet dhe rezultatet e dala nga sistemi i SIPK-ut, gjatë viteve 2013-2023, përveç ndihmës në monitorimin e proceseve, menaxhimin, planifikimin dhe rishikimin e tyre, kanë krijuar një bazë të rëndësishme edhe për avancimin e sistemit të SIPK-ut, në Sistem të Menaxhimit të Përformancës të ASK-së si dhe vete procesit të Raportimit Vjetor të Punës.

2.4 Dialogu me përdoruesit

Të gjitha kërkesat e paraqitura përmes formës elektronike nga përdorues të ndryshëm si dhe zhvillimet e brendshme në ASK janë transmetuar tek përdoruesit e në veçanti me komunitetin e gazetarëve janë realizuar komfor programit të ASK-së. Ky prioritet, si objektiv strategjik ka vendosjen e një dialogu sistematik me përdoruesit. Në këtë drejtim janë mbajtur takime me Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht ARC-në, Universitetin Publik të Prishtinës, Ministrinë e Financave, Bankën Qendrore, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, MASHT-in, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Avokatin e Popullit dhe me institucione të tjera të Republikës së Kosovës, rreth shkëmbimit të të dhënave, metodologjisë dhe qëndrueshmërisë së të dhënave statistikore. Kjo formë e bashkëpunimit është shumë e rëndësishme dhe do të fuqizohet në vazhdimësi. Në kudër të këtij prioriteti, ASK-ja ka realizuar konferenca me institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ligjërata me studentë të UP-së, për mënyrën e qasjes në të dhënat e Statistikave Zyrtare dhe shfrytëzimin sa më të lehtë të tyre. Me theks të veçantë një sub-ordinim me institucione, përdorues dhe ofrues të dhënave zyrtarë ka qenë lidhur me Ligjin mbi Regjistrimin e Popullsisë.

2.5 Prioritetet tjera sektoriale - Prodhimi statistikor

Më poshtë janë listuar disa prioritete të realizuara në kuadër prodhimeve statistikore:

- Publikimi i BPV-së në baza tremujore ka qenë i rregullt dhe është publikuar sipas standardeve (T+75 ditë)
- Është shkurtuar afati kohor për publikimin e BPV në baza vjetore (T+9 muaj);
- Publikimi i Llogarive Qeveritare në baza tremujore (T+90 ditë);
- Është shkurtuar afati kohor për publikimin e Llogarive Qeveritare në baza vjetore (T+5 muaj);
- Për plotësimin e kërkesave të ndryshme të shfrytëzuesve, të dhënat e Tregtisë së Jashtme janë vendosur në platformën e re Px-Ueb në ASKDATA. Koha e prodhimit të STJ, në baza mujore në T+24 ditë nga T+27;
- Janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme për fazën përgatitore për Projektin e Regjistrimit të

Populllsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2023;

- Shkurtimi i afateve kohore është arritur edhe të publikimi, Statistikat e Mirëqenies Sociale në ku nga publikimet tremujore kemi kaluar në publikimin e të dhënave në baza mujore (T+25 ditë)
- Është shkurtuar afati i publikimit të TIK në Ekonomi Familjare 2023 për 26 ditë krahasuar me vitin 2022;
- Është aplikuar për herë të parë metoda CATI në AFP për grumbullimin e të dhënave për anketat;
- Është aplikuar për herë të parë metoda CAËI në grumbullimin e të dhënave për arsimin e lartë 2023/2022 ;
- Mostra e Anketës së Ekonomive Bujqësore, është dizajnuar, duke shfrytëzuar të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë 2014, të freskuara me të dhënat e AEB 2015; AEB 2022 ;2023 dhe AEB 2022. Është bërë rritja e mostrës së AEB 2022 për 20 % krahasuar me vitin 2022 dhe mostra e AHS është dizajnuar në tre mostra të veçanta (Blegtoria, Kulturat bujqësore bimore dhe Anketa ekonomike) që të përmirësojë cilësinë. Për Anketën e Kulturave Bujqësore janë përzgjedhur 6000 Ekonomi Bujqësore (EB) për Anketën e Blegtorisë 3000 EB dhe për Anketën Ekonomike Bujqësore 800 EB. Kjo është e harmonizuar me metodologjinë dhe definicionet e Eurostatit;
- Është shkurtuar afati kohor i publikimit të rezultateve të Llogaritjeve Ekonomike në Bujqësi 2023 për 22 ditë krahasuar me vitin 2022;
- Është përmirësuar aplikacioni për grumbullimin e të dhënave në teren për Anketën e Ekonomive Bujqësore 2023 pra janë shtuar më shumë rregulla të validitimit në aplikacion që mundësojnë cilësi më të mirë të grumbullimin i e të dhënave në teren. AEB 2023 është realizuar me metodën CAPI (intervistimi duke shfrytëzuar tabletat);
- Është azhurnuar Harta Rrugore për Statistikat e Bujqësisë për periudhën 2022 – 2023, në veçanti pjesa që ka të bëjë me Regjistrimin e Bujqësisë;
- Janë dërguar në Eurostat të dhënat e Statistikave të Kulturave Bujqësore Bimore; Blegtorisë dhe Prodhimeve Blegtorale; Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi (Indekset tremujor dhe vjetor), Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi dhe Statistikat e Mbeturinave.
- Në fushën e Statistikave të Mjedisit gjatë vitit 2023 janë publikuar dy publikime të reja (për herë të parë). Këto janë, Taksat Mjedisore 2019 -2023 në Kosovë dhe Llogaritë e Emetimeve në ajër 2022.
- Është bërë Vlerësimi i numrit të Popullsisë së përgjithshme për vitin 2022. Vlerësimi është bërë në nivel të Komunave dhe është publikuar në dhjetor të vitit 2023;
- Në sajë të marrëveshjes së bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, janë prodhuar Statistikat e Turizmit edhe gjatë vitit 2022;
- Viti 2023 karakterizohet si vit i avancimit të Teknologjive dhe Metodologjive të reja për procesin e mbledhjes së të dhënave përmes aplikimit të metodave CAPI dhe CAWI.
- Numri i tabelave të integruara në ASKdata deri më tani ka arritur shifrën mbi 1050, duke e bërë këtë platformë më të frekuentuarën nga shfrytëzuesit të jashtëm.
- Është nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi në mes të ASK dhe Institucionit të Avokatit të Popullit dhe UNDP;
- Është përgatitur dhe nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit mes: ASK-MSH dhe ARC.

3. BUXHETI

Agjencisë së Statistikave të Kosovës sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023 i është ndarë buxhet në vlerë prej 11,546,439.00 € për kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe komunalit. Sipas Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023 buxheti i ASK-ës është ndarë:

- Paga dhe mëditje 1,058,208.83 €,
- Mallra dhe shërbime 10,466,356 € dhe
- Komunale 21,875 €.

Në kategorinë mallra dhe shërbime kryesisht buxheti është i Regjistrimit të Popullsisë që ishte paraparë të mbahet në nëntor të vitit 2023.

Duke parë të domosdoshme kryerjen e disa aktiviteteve në fushën e Teknologjisë Informative-, Qeveria e Kosovës me Vendim Nr.24/148 të datës 29.06.2023 ka ndarë mjete në vlerë 10,000€ nga "Shpenzimet e Paparashikuara" për krijimin e projektit të ri kapital "Furnizimi me pajisje të TI". Pas krijimit të projektit kapital ASK ka bërë kërkesë për transfer të mjeteve në vlerë 211,000.00 € nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë kapitale, bazuar në Ligjin (03/L-048) për Financat Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Neni 30 - Rregullimi i ndarjeve buxhetore si dhe Ligjin Nr.08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Neni 15 -Transferi i shumave të ndara buxhetore.

Duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë për Regjistrim të Popullsisë të datës 22.11.2023 që Regjistrimi i Popullsisë i Ekonomive Familjare dhe banesave do të realizohet në periudhën kohore 05 prill -17 maj 2024, ASK duke e parë që në vitin 2023 nuk mund të realizohet Regjistrimi i Popullsisë paraqet kursime në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë 7,663.406.00€ që janë kryesisht të parapara pagesat e Mbikëqyrësve dhe Regjistruesve.

Në totalin e buxhetit të ASK-së, për vitin 2023, ASK- ja ka arritur të realizojë rreth 74.31% të planit të saj buxhetor. Dihet se komponenti buxhetor është përcaktuese për avancimin e Statistikave Zyrtare të Kosovës dhe përafrimin e tyre me statistikat e vendeve të BE-së.
Nga të gjitha fondet në dispozicion për ASK-në, për vitin 2023, shpërndarja dhe realizimi është si në vijim:

Tab. 3.1: Shpërndarja dhe realizimi i fondeve

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar 2023	Buxheti final 2023	BK-Buxheti I realizuar 2023	Shprehur në % nga buxheti final
Paga dhe shtesa	1,058,208.83	1,216,434.01	1,216,434.01	100
Mallra e shërbime	10,466,356.00	2,802,950.50	1,745,685.57	62.28
Shpenzimet komunale	21,875.00	21,875.00	14,482.83	66.21
Pasuritë jo financiare	00	221,000.00	190,748.96	86.31
Gjithsej	**11,546,439.83**	**4,262,259.51**	**3,167,351.37**	**74.31**

Paga dhe mëditje buxheti fillestar sipas Ligjit mbi ndarjet Buxhetore 08/L-193 për vitin 2023 është ndarë 1,058,209.00€ . Me hyrjen ne fuqi te Ligjit te pagave ne vitin 2023 buxheti i ndare ka qene i pamjaftueshëm dhe kemi një rritje në vlerë 158,225.00€ qe është mbuluar nga Buxheti i Kosovës. Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje eshë 1,216,434.00 €.

Siç shihet në tabelën e mësipërme, buxheti i realizuar është në shkallën rreth 74.31%.

Ndërsa në tabelën e mëposhtme janë prezantuar shpenzimet sipas Departamenteve përkatëse të ASK-së, në kuadër të kategorisë Mallra dhe Shërbimeve.

Tab. 3.2: Shpenzimet (Kategoria Mallra dhe Shërbime) sipas Departamenteve për vitin 2023

DEPARTAMENTET	Shuma në EUR	Shprehur në %
Regjistrimi I Popullsisë	1,455,667.52	83.39
Departamenti i Administratës	61,343.20	3.51
Departamenti i Statistikave Ekonomike	71,826.98	4.11
Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit	63,128.09	3.62
Departamenti i Statistikave Sociale	61,752.91	3.54
Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve	21,949.07	1.26
Departamenti I Metodologjisë dhe TI-së	6,200.31	0.36
Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim	2,094.10	0.12
Departamenti i Llogarive Kombëtare	1,723.40	0.10
Gjithsej	**1,745,685.57**	**100.00**

Realizimi i anketave të ndryshme statistikore paraqitet ne tabelën 3.3.

Tab. 3.3: Shpenzime për aktivitetet të cilat zhvillohen në baza vjetore

Hulumtimet/Anketat	Shuma në EUR
Regjistrimi i Popullsisë	34,251.53
Anketa e Mbeturinave Industriale Anketa e Mbeturinave të Trajtuar; Anketa e Ekonomive Bujqësore	59,002.09
Anketa-TIK në Ekonomi Familjare Anketa-SILC Rianketa- Fuqisë Punëtore-AP; Anketa per Arsim	54,393.16
Anketa e Turizmit Anketa-TIK në Ndërmarrje Anketa-Konsumi i Energjisë në Ekonomit Familjare	39,447.76
Anketa-ASN Anketa -Investime në ndërmarrje Anketa-ProdCom	30,328.72
Anketat tjera	15,435.00
Gjithsej	**232,858.25**

Në vitin 2023 janë mjete të bartura të donacioneve në vlerë: 288,432.63 € ndërsa hyrje në vitin 2023 kemi mjete në vlere: 81,000.00 € nga IPA.

Gjatë vitit 2023, ASK-ja ka pasur mbështetje financiare nga donatori IPA, Vlera e mjeteve në total nga donacionet në vitin 2023, ishte 369,432.63 €, ku prej tyre janë realizuar: 22,096.22 €.

Tab. 3.4: Shpenzimet e financuara nga Donatori IPA:

Përshkrimi	Shuma Euro
Organizimi i vizitave studimore jashtë vendit për Raportet Statistikore	**14,614.22**
Eksperti i IT per anketën e mbeturinave industriale	**6,960.00**
Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	**522.00**
Gjithsej	**22,096.22**

Gjatë gjithë procesit të menaxhimit të fondeve publike, ASK-ja ka zbatuar dhe vepruar në përputhje të plotë me Ligjin mbi financat publike dhe përgjegjësitë si dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

4. SFIDAT gjatë vitit 2023

ASK-ja, gjatë vitit 2023 është ballafaquar me vështirësi të ndryshme, si në aspektin e infrastrukturës së nevojshme fizike, ashtu edhe në aspektin e vështirësive në plotësimin e pozitave të lira (rekrutimi i stafit).

- Pamundësia ne shfrytëzimin e fondeve për Pilot Projektet përkrahur nga Eurostat ;
- Numri i pamjaftueshëm i stafit për të filluar me produktet e reja statistikore dhe për zgjerimin e atyre ekzistuese;
- Pamundësia në mbulimin e pozitave të lira (te paplotësuara) nga procesi i pensionimit të stafit;
- Sigurimi i indikatorëve, gjegjësisht monitorimi i Strategjisë 2030 per OZHQ;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave statistikore (përmirësimi i cilësisë);
- Krijimi i një sistemi unik statistikor të TI-së;
- Qasja e pamjaftueshme në të dhëna administrative;
- Harmonizimi i Statistikave ndërmjet ASK-së dhe institucioneve, që janë prodhuese të statistikave;
- Aktivitetet në realizimin e Projektit të Regjistrimit të Popullsisë 2023;
- Implementimi i Pilot-Projekteve IPA 2019 si dhe projektet me donatorë të tjerë;
- Ndryshimet në Kornizën Ligjore në nivel vendi, kanë ndikuar në proceset e ASK-së;
- Mungesa e hapësirës fizike për sistemim të stafit;
- Proceset administrative në zhvillimin e aktiviteteve sidomos atyre të prokurimit;
- Mos raportimi i të dhënave nga Institucionet tjera të Republikës së Kosovës.

SHTOJCA 1.

Pasqyra e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës në ASK, dhjetor 2023

Struktura kualifikuese	Struktura etnike	Struktura gjinore	Gjithsej
Fakultet - 111	Shqiptarë -124	Femra - 70	137
Shkolle te mesme - 12	Serbë - 10	Meshkuj - 67	
Shkolle fillore - 0	Turke - 1		
	të tjerë - 0		

Pasqyrat sipas modaliteteve

Struktura etnike

Struktura etnike	Numri
Shqiptarë	124
Serb	10
Boshnjak	2
Turk	1
Të tjerë	0
Gjithsej	**137**

Struktura kualifikuese

Struktura Kualifikuese	Numri
Master	14
Fakultet	111
Shkolle të mesme	12
Gjithsej	**137**

Struktura Gjinore

Struktura Gjinore	Numri
Meshkuj	67
Femra	70
Gjithsej	**137**

Fig. 3. Struktura gjinore